

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6597
E hënë, 5 maj 2022
çmimi 0.40 €

Më 18 maj shpallet
aktgjykimi ndaj Guçatit
e Haradinajt | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com


facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KANCELARI I GJERMANISË, OLAF SCHOLZ, TAKON NË BERLIN
KRYEMINISTRIN E KOSOVËS, ALBIN KURTI | FAQE 3

QËNDRIMI I GJERMANISË: NJOHJA E KOSOVËS NGA SERBIA, PJESË E DIALOGUT

Kancelari gjerman: Do të angazhohem me
këmbëngulje që Kosovës t'i liberalizohen vizat



Kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz, pas takimit me kryeministrin Albin Kurti, ka thënë se njohja e Kosovës nga Serbia është pjesë e dialogut. "Objektivi i dialogut të Brukselit është një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e qëndrueshme midis dy vendeve që ua hap të dyja vendeve perspektivën e Bashkimit Evropian dhe kontribuon për stabilitetin rajonal", ka deklaruar Scholz. Ndërsa sa i përket liberalizimit të vizave, ai ka premtuar se do të angazhohet me këmbëngulje që të ndodhë një gjë e tillë. Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se "njohja reciproke duhet të jetë në qendër dhe jo në fund të procesit" të dialogut me Serbinë

Prokuroria e Gjykatës Speciale ka dorëzuar një aktakuzë të plotësuar kundër ish-liderëve të UÇK-së. Në aktakuzën e plotësuar prokurori Jack Smith ka përfshirë disa krime të pretenduara në Suharekë dhe Gjilan. Faton Klinaku, ushtrues i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, ka thënë se zgjerimi i aktakuzës ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka të bëjë me zgjatjen e mandatit të Gjykatës Speciale. Klinaku ka thënë se Specialja nuk është treguar serioze kur në aktakuzë përmend frazën se "këta persona kanë mundur të jenë në dijeni". Ndërsa avokati Taulant Hodaj ka thënë se me pikat e reja të aktakuzës procesi i gjyqimit ndaj ish-liderëve të UÇK-së mund të shtyhet edhe për dy vjet



ZPS-ja DORËZON AKTAKUZË TË PLOTËSUAR KUNDËR ISH-DREJTUESVE TË UÇK-së

FAQE 4-5

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

OPINION

DEMONSTRATAT E VITIT
1981 SIPAS DOKUMENTEVE
BRITANIKE | F. 3

Shkruan:
Prof.dr. Sabit SYLA



AKTUALE

MINISTRI MEHAJ: KOSOVA DUHET
T'I KETË 20 MIJË REZERVISTË
VULLNETARË | F. 5

JEP DORËHEQJE MINISTRI DANEZ
QË NËNSHKROI MARRËVESHJEN ME
KOSOVËN PËR BURGJET | F. 6

DEKLAROHEN TË PAFAJSHËM
LEKAJ DHE TË AKUZUARIT
E TJERË NË RASTIN E 53 MILIONË
EUROVE | F. 6

EKONOMI

BANKA BOTËRORE 'ALARMON' PËR
RËNIEN EKONOMIKE TË KOSOVËS
DHE SHTETEVE TË RAJONIT | F. 8

PKD-JA: NË MARS KOSOVA
IMPORTOI 0.56 PËR QIND ENERGJI,
POR QYTETARËT VAZHDOJNË
TË PAGUAJNË ME RITJE | F. 8

SPORT



ISH-KOMANDANTI I UÇK-SË
EMËROHET ANËTAR I KE TË FFK-SË

F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Von der Leyen propozon embargo mbi naftën ruse, Hungaria dhe Sllovakia kundër

STRASBURG, 4 MAJ - Bashkimi Evropian (BE) do të heqë dorë plotësisht nga nafta e papërpunuar ruse dhe produktet e rafinuara deri në fund të vitit, ka bërë me dije presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, teksa ka njoftuar të martën për raundin e gjashtë të sanksioneve kundër Moskës për shkak të pushtimit të Ukrainës. “Ne do të heqim dorë nga furnizimet nga nafta e papërpunuar brenda gjashtë muajsh dhe produkteve të rafinuara deri në fund të vitit. Kjo do të jetë ndalesë e plotë ndaj importit të naftës ruse që vjen nga cisternat dhe tubacionet, nafta e papërpunuar dhe ajo e rafinuar. Nuk do të jetë e lehtë. Disa shtete anëtare janë shumë të varura nga



nafta ruse. Por, ne thjesht duhet të punojmë për këtë”, tha ajo para Parlamentit Evropian në Strasburg, teksa prezantoi propozimin i cili duhet të miratohet nga të gjitha 27 shtetet që të hyjë në fuqi.

Von der Leyen nuk ka përmendur asnjë përjashtim nga kjo ndalesë, edhe pse Hungaria dhe Sllovakia, dy shtete anëtare të bllokut, janë shumë të varura nga importet e energjisë ruse dhe janë shprehur kundër ndalesës. Megjithatë,

presidentja e Komisionit Evropian ka thënë se një vendim unanim për sanksionet mbi naftën “nuk do të jetë i lehtë”. Von der Leyen, po ashtu, ka njoftuar për largimin e bankës më të madhe ruse “Sberbank” nga

sistemi ndërkombëtar i komunikimit financiar, SWIFT.

“Në pakon e gjashtë të sanksioneve, që pritet të miratohet në ditët në vijim, do të jenë edhe zyrtarët ushtarakë të përfshirë në mizoritë e kryera në Buça dhe Mariupol”, ka thënë von der Leyen.

Po ashtu, zyrtarja e lartë e BE-së ka thënë se tri medie shtetërore ruse do të largohen nga transmetimet në BE pasi, sipas saj, këto janë “megafonë të gënjeshtreve të Putinit”.

Sanksionet e paralajmëruara nga BE-ja vijnë teksa forcat ruse po godasin objektiva në lindje të Ukrainës, duke sulmuar me raketa fabrikën e çelikut në Mariupol, që është pika e fundit e rezistencës.

Turqia thyen rekord botëror, prodhon helikopter pa pilot

ANKARA, 4 MAJ - Është bërë me dije se Industria e Hapësirës Ajrore e Turqisë (TAI) ka dorëzuar helikopterin taktik të zbulimit dhe sulmit “T129”. Kjo industri e ka paraqitur për herë të parë helikopterin me energji elektrike “T629” në Drejtorinë e Përgjithshme të Sigurisë. Helikopteri sulmues “T629”, i

cili ka qenë në zhvillim e sipër nga TAI-ja, është ekspozuar gjatë një ceremonie në të cilën Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë e Turqisë ka marrë helikopterin e saj të parë taktik të zbulimit dhe sulmit “T129” (ATAK).

Një tjetër mjet i planifikuar për t’u ngritur më 2023 është

aeroplani luftarak kombëtar “TF-X”. Ai është vendosur të kombinojë më të mirën e një mjeti të epërsisë ajrore “stealth”, me aftësi shtesë sulmi në tokë dhe një grup mbresëlënës sensorësh, radar të fundit, kontroll të rrjetit të dronëve dhe kapacitet raketash hipersonike.



Britania e gatshme ta ndihmojë Finlandën ose Suedinë në rast të një sulmi nga Rusia

LONDËR, 4 MAJ - Në një konferencë të përbashkët për medie me homologun e tij finlandez, sekretari i Mbrojtjes, Ben Wallace, ka thënë se Britania e Madhe do të jetë e gatshme ta ndihmojë Finlandën në rast të një sulmi nga Rusia. Finlanda dhe Suedia janë duke e shqyrtuar aplikimin për anëtarësimin në NATO, megjithëse janë përballur me kërcënime nga Rusia. “Është e

paimagjinueshme që Britania të mos mbështesë Finlandën apo Suedinë nëse do të sulmoheshin. Ne jemi vende evropiane që ndajmë të njëjtat vlera”, ka thënë Wallace.

Ndërsa sa i përket anëtarësimin në NATO, sekretari britanik ka thënë se Finlanda është e lirë për të zgjedhur nëse dëshiron ose jo të bashkohet me aleancën ushtarake.

Më 16 maj mbahet raundi i parë për zgjedhjen e presidentit të Shqipërisë

TIRANË, 4 MAJ - Mazhoranca në Shqipëri ka rënë dakord me propozimin e kreu të grupit parlamentar të PD-së, Enkelejd Alibeaj, i cili ka kërkuar që data 10 maj të quhet data e nisjes së procesit të zgjedhjes së presidentit. Fillimisht kreu i grupit

parlamentar i PS-së, Taulant Balla, është shprehur se më 16 maj do të jetë raundi i parë i votimit të presidentit të Republikës së Shqipërisë. “Bie dakord me propozimin e Alibeajt, por mbledhja të konsiderohet vijuese. Pra data 16 të jetë raundi i parë i

zhvillimit të procesit të votimit, ndërsa data 10 të jetë data e nisjes së procesit. Do t’ju ftoja të tre kryetarëve. Edhe zotin Alibeajn si kryetar i grupit më të madh opozitar që të mundësojmë një dialog parimor për presidentin”, ka thënë Balla.



Kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz, takon në Berlin kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti

Qëndrimi i Gjermanisë: Njohja e Kosovës nga Serbia, pjesë e dialogut

Kancelari gjerman: Do të angazhohem me këmbëngulje që Kosovës t'i liberalizohen vizat

Kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz, pas takimit me kryeministrin Albin Kurti, ka thënë se njohja e Kosovës nga Serbia është pjesë e dialogut. "Objektivi i dialogut të Brukselit është një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e qëndrueshme midis dy vendeve që ua hap të dyja vendeve perspektivën e Bashkimit Evropian dhe kontribuon për stabilitetin rajonal", ka deklaruar Scholz. Ndërsa sa i përket liberalizimit të vizave, ai ka premtuar se do të angazhohet me këmbëngulje që të ndodhë një gjë e tillë. Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se "njohja reciproke duhet të jetë në qendër dhe jo në fund të procesit" të dialogut me Serbinë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

BERLIN, 4 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të martën është takuar në Berlin me kancelarin e Gjermanisë, Olaf Scholz. Pas takimit ata kanë mbajtur një konferencë për medie në të cilën kanë treguar se çfarë kanë biseduar prapa deryve të mbyllura. Kancelari Scholz është shprehur i lumtur me bashkëpunimin e dy qeverive, duke thënë se do ta forcojnë edhe më tutje bashkëpunimin me Kosovën. Në këtë drejtim, ai ka përmendur liberalizimin e vizave për Kosovën si çështje shumë e rëndësishme për të cilën ka premtuar se angazhohet vazhdimisht. "Përparimi i mëtejshëm duhet të bëhet tani edhe për liberalizimin e vizave për Kosovën. Qeveria federale e ka fiksuar këtë si objektiv në marrëveshjen e koalicionit. Për këtë unë angazhohem me këmbëngulje në Bashkimin Evropian, në biseda me partnerët. Angazhohem me këmbëngulje", ka thënë kancelari

gjerman, i cili ka paralajmëruar vizitë në Prishtinë.

Në adresimin e tij para medieve, Scholz ka përmendur edhe bashkëpunimin rajonal, duke thënë se "me Procesin e Berlinit, Gjermania ka vite që angazhohet në Ballkanin Perëndimor".

"Projekti më i rëndësishëm është krijimi i një tregu të përbashkët rajonal", ka thënë ai, duke paralajmëruar marrëveshje për lëvizjen e lirë të personave dhe njohjen e diplomave profesionale.

Ndërsa sa i përket procesit të dialogut me Serbinë, kancelari gjerman ka thënë se njohja e

pavarësisë së Kosovës është pjesë e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve.

Duke iu referuar marrëveshjes së pritur në mes të Kosovës dhe Serbisë, Scholz ka thënë se dokumenti do të ketë shumë detaje, por se do ta përfshijë edhe njohjen e Kosovës. "Objektivi i dialogut të Brukselit është një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e qëndrueshme midis dy vendeve që ua hap të dyja vendeve perspektivën e Bashkimit Evropian dhe kontribuon për stabilitetin rajonal", ka deklaruar Scholz, duke shtuar se janë të



interesuar që marrëveshja Kosovë - Serbi të arrihet sa më shpejt.

"Sa iu përket periudhave kohore, ne nuk mund të themi sepse kjo varet nga organe të tjera, por ne jemi të interesuar që kjo të ndodhë shpejt", ka thënë ai.

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se "njohja reciproke duhet të jetë në qendër dhe jo në fund të procesit" të dialogut me Serbinë.

Kurti ka thënë se Kosova është "proaktive dhe konstruktive" në dialog dhe se është duke bërë propozime që janë në përputhje me vlerat e Bashkimit Evropian. "Në lidhje me dialogun me Serbinë e njoftova kancelarin se Kosova është pro aktive dhe konstruktive në dialog, duke sjell edhe propozime në linjë me vlerat e BE-së. Dialogu duhet të jetë i përqendruar në njohje reciproke, pra jo në njohje që vjen në fund të një procesi të gjatë, por si dialog për marrëveshje me njohje reciproke në qendër. Pikëpamja e bindja jonë është që njohja reciproke duhet të jetë në qendër e

jo në fund. Ne jemi të përkushtuar që të ecim shpejt, të kemi rezultate konkrete dhe të bashkëpunojmë shumë", ka thënë Kurti.

Kurse sa i përket liberalizimit të vizave, kryeministri Kurti ka thënë se Kosova ka kryer detyrat e saj dhe se tani është radha e BE-së ta bëjë të njëjtën gjë. "Në korrik, pra edhe dy muaj, bëhen 4 vjet prej se Komisioni Evropian ka rekomanduar liberalizimin e vizave për Kosovën për herë të dytë dhe ka konstatuar që Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret. Tash është koha të thuhet se mjaft është mjaft dhe kjo çështje të vendoset për vendimmarrje në Këshillin e BE-së, pasi Kosova i ka kryer detyrat e shtëpisë dhe është radha që BE-ja ta bëjë të vetën", ka thënë Kurti.

Kancelari gjerman dhe kryeministri i Kosovës kanë bërë me dije se kanë biseduar edhe për luftën në Ukrainë. Pas takimit të Scholzit me Kurtin, kancelari gjerman është takuar edhe me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Gjermania mbështet anëtarësimin e Kosovës në Këshill të Evropës



BERLIN, 4 MAJ - Qeveria e Gjermanisë ka konfirmuar se mbështet anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës (KE). Deputeti gjerman Knut Abraham ka thënë se e ka pyetur ekzekutivin e tij nëse do ta mbështeste aplikimin e Kosovës për anëtarësim në këtë mekanizëm dhe se përgjigjja ka qenë pozitive. Abraham ka publikuar një letër ku, mes të tjerash, është thënë se Qeveria Federale e Gjermanisë "mbështet anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës".

"Është e rëndësishme të qëndrojmë në koordinim të ngushtë me partnerët tanë në Bashkimin Evropian dhe në Këshillin e Evropës", është thënë në letrën që ka shpërndarë deputeti Abraham.

Letra është nënshkruar nga Andreas Michaelis, i cili shërben si sekretar i shtetit i Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë. Këshilli i Evropës është një organizatë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit në Evropë.

Nga Qeveria e Kosovës kanë thënë më herët se planifikojnë që së shpejti të aplikojnë për anëtarësim në këtë mekanizëm. Kosova ka shpallur pavarësinë në vitin 2008, por nuk ka arritur ende të anëtarësohet në disa organizata të rëndësishme ndërkombëtare. Ajo nuk është ende as anëtare e Bashkimit Evropian, as e Organizatës Botërore të Tregtisë, as e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale e të tjera. Serbia ka qenë e angazhuar në fushatë për pengimin e Kosovës, së

bashku me mbështetësen e saj kryesore në arenën ndërkombëtare, Rusinë.

Kosovën nuk e njohin ende as pesë vendet e Bashkimit Evropian: Greqia, Spanja, Rumania, Sllovakia dhe Qiproja. Kosova, megjithatë, ka arritur të anëtarësohet në disa organizata ndërkombëtare, si në tyre: Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Komitetin Olimpik, Federatën Evropiane të Futbollit dhe Federatën Botërore të Futbollit.

Osmani në Amerikën Latine, vizitë zyrtare në dy shtete

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Presidentja Vjosa Osmani ka udhëtuar fillimisht në Panama për vizitë zyrtare në këtë shtet, për ta vazhduar pastaj vizitën zyrtare në Kosta Rikë, ka njoftuar Presidencës e Kosovës.

Gjatë vizitës në Panama presidentja Osmani do të

pritet në takim nga homologu Laurentino Cortizo Cohen, ndërsa do të zhvillojë takime edhe me institucione dhe organizata të tjera.

Në këtë vizitë presidentja Osmani pritët të marrë pjesë në ceremoninë e zbulimit të shtatores së Nënë Terezës si

dhe në një forum të përbashkët me ministren e punëve të Jashtme të Panamasë, Erika Mouynes.

Pas vizitës në Panama, presidentja Osmani, me ftesë të presidentit të Kosta Rikës, do të marrë pjesë në inaugurimin e presidentit të ri të këtij shteti, Rodrigo Chaves.

Kosta Rika, sipas datës së njohjes, është ndër vendet e para që e ka njohur pavarësinë e Kosovës, ndërsa vizita e presidentes Osmani është e para e një lideri të Kosovës në këtë shtet. Në kuadër të kësaj vizite, presidentja Osmani pritët të ketë edhe takime të tjera.





ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (ZPS) TENTON TA ZVARRISË PROCESIN GJYQËSOR
NDAJ THAÇIT, VESELIT, SELIMIT DHE KRASNIQIT

ZPS-ja dorëzon aktakuzë të plotësuar kundër ish-drejtuësve të UÇK-së

Prokuroria e Gjykatës Speciale ka dorëzuar një aktakuzë të plotësuar kundër ish-liderëve të UÇK-së. Në aktakuzën e plotësuar prokurori Jack Smith ka përfshirë disa krime të pretenduara në Suharekë dhe Gjilan. Faton Klinaku, ushtrues i detyrës së kryetarit të OVLUÇK-së, ka thënë se zgjerimi i aktakuzës ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka të bëjë me zgjatjen e mandatit të Gjykatës Speciale. Klinaku ka thënë se Specialja nuk është treguar serioze kur në aktakuzë përmend frazën se “këta persona kanë mundur të jenë në dijeni”. Ndërsa avokati Taulant Hodaj ka thënë se me pikat e reja të aktakuzës procesi i gjykimit ndaj ish-liderëve të UÇK-së mund të shtyhet edhe për dy vjet

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka dorëzuar më 29 prill në Gjykatën Speciale aktakuzë të plotësuar kundër ish-presidentit Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi si dhe ish-deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi. Versionin e redaktuar të aktakuzës së plotësuar, Gjykata Speciale e ka publikuar të martën në uebfaqen e saj. Në aktakuzën e plotësuar prokurori Jack Smith ka përfshirë disa krime të pretenduara në Suharekë dhe Gjilan, për të cilat akuzohen ish-krerët politikë dhe ushtarakë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Aktakuza e plotësuar është më pak konfidenciale dhe ka më pak pjesë të redaktuara. Sikurse në aktakuzën e dorëzuar më parë, edhe në aktakuzën e ndryshuar prokuroria i akuzon

Thaçin, Veselin, Krasniqin dhe Selimin për vrasje, tortura, trajtim çnjerëzor e arrestime të paligjshme. Prokuroria ka renditur akuza për krime që pretendohet të jenë kryer në disa shtëpi nga ish-pjesëtarët e UÇK-së. “Anëtarët e UÇK-së ua hoqën lirinë së paku 12 personave pa proces të rregullt, duke i mbajtur të arrestuar në lokacione si Budakovë e Semetishtë, në periudha të ndryshme ndërmjet 4 korrikut 1998 dhe 29 prillit 1999. Më 4 korrik një person (redaktuar) po ngiste një kamionetë, kur tre burra e ndaluan nga (redaktuar) dhe (redaktuar), të cilët kishin veshur uniforma të zeza dhe mbanin pushkë automatike. Një person i tretë me uniformë mbërriti dhe qëndroi përballë me një raketahedhëse. I futën në bagazhin e automjetit dhe i dërguan në një shtëpi në Budakovë. Të tre burrat u vendosën në një bodrum dhe pastaj u rrahën”, është thënë në

pjesën e re të aktakuzës. Ish-pjesëtarët të UÇK-së, pa u specifikuar me emra, akuzohen se u kishin shkakuar “vuajtje ose lëndime të rënda mendore ose fizike”, si dhe kishin “sulmuar dinjitetin e viktimave, duke i ndaluar në mënyrë arbitrare”. “Një person (redaktuar) dhe një shqiptar tjetër, kur u arrestuan rreth datës 4 korrik 1998, ua drejtuan edhe armët. Ndërsa po largoheshin nga vendi i arrestimit, u qëllua në (redaktuar). Pas arrestimit tre burrat i dërguan në një shtëpi në Budakovë dhe i rrahën për një orë. Tre burrat konsideroheshin se ishin bashkëpunëtorë të Serbisë dhe u torturuan edhe me ujë të nxehtë”, është thënë në aktakuzë. Në versionin e ndryshuar të aktakuzës janë përfshirë edhe vrasje që pretendohet të jenë kryer në Budakovë e Semetishtë. “Kufomat e të arrestuarve u gjetën rreth datës 23 gusht 1998, me gjurmët e armëve që i përkiste personit (redaktuar). Analiza e ADN-së konfirmoi se njëra nga

kufomat e varrosura ishte e (redaktuar)”, thuhet në aktakuzë dhe shtohet se kjo “demonstroi qëllimin e tyre për t’i vrarë ose për t’u shkakuar lëndime me dashje”, është thënë në aktakuzën e re. Në konviktin e Gjilanit, në disa raste, pretendohet të jenë kryer krime të ngjashme, për të cilat prokuroria i bën përgjegjës Thaçin dhe të tjerët. “Në konvikt, një person (redaktuar), u kontrollua dhe iu morën çelësat e veturës dhe iu shqye patentshoferi. Ai pasi u arrestua, u rrah me shkopinj, dhe njëri prej personave e vendosi pistoletën te viktima. Rrahja u krye në mënyrë të organizuar, dhe një nga personat jepte udhëzime si të kryhej rrahja”, është thënë në pjesët shtesë të aktakuzës. Përmendet edhe një rast tjetër ku, sipas prokurorisë, një person ishte rrëmbyer në Gjilan për t’u dërguar drejt Konviktit dhe, sipas Prokurorisë, “nuk u pa kurrë më”. “Trupi i tij u gjet më 2 qershor 2000. Vetëm dy ditë më vonë një tjetër person u arrestua dhe u dërgua në konvikt dhe nuk u pa më kurrë. Trupi i tij u gjet në vitin 2022”, është thënë në aktakuzën e ZPS-së. Ish-krerët e UÇK-së akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Aktakuza i bën përgjegjës Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin për një sërë krimesh që pretendohet se janë kryer në disa qendra ndalimi gjatë viteve 1998-1999. Prokuroria e

Specializuar i akuzon ata se kanë qenë ose duhej të ishin në dijeni të këtyre krimeve.

Ndaj plotësimit të aktakuzës ka reaguar Faton Klinaku, ushtrues i detyrës së kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai ka thënë se zgjerimi i aktakuzës ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit ka të bëjë me zgjatjen e mandatit të Gjykatës Speciale. “Prokurorit Smith i intereson të zgjasë procesi edhe 20 vjet pasi ka pagë ta majme. Ai nuk punon për asgjë tjetër pos për miliona ashtu si gjithë prokurorët e gjykatësit, por edhe avokatët. Natyrisht se me zgjerimin e aktakuzave zgjatet edhe procesi gjyqësor”, ka thënë ai në “RTV Dukagjini”.

Klinaku ka thënë se Specialja nuk është treguar serioze kur përmend në aktakuzë frazën se “këta persona kanë mundur të jenë në dijeni”. “S’mund të flitet kështu për një ngjarje që ka kaluar. Ose kanë mundur të jenë në dijeni ose jo”, ka thënë Klinaku.

I pari i veteranëve të UÇK-së ka thënë se në aktakuzën e plotësuar përmenden civilë serbë të vrarë mirëpo, sipas tij, në zonat ku përmenden nuk ka pasur civilë serbë të vrarë, por vetëm ushtarë, paramilitarë e policë serbë që ishin të armatosur.

Në anën tjetër, Taulant Hodaj, avokat i akredituar nga Specialja, ka komentuar plotësimin e

Më 18 maj shpallet aktgjykimi ndaj Gucatit e Haradinajt

HAGË, 4 MAJ - Trupi gjyqës, i kryesuar nga Charles L. Smith II, ka vendosur që më 18 maj në orën 10:00 ta shpallë aktgjykimin ndaj drejtuesve të OVLUÇK-së, Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

Gucati e Haradinaj janë duke u akuzuar nga Gjykata Speciale për vepra penale që ndërlidhen me pengimin e administrimit të drejtësisë.

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka kërkuar që Hysni Gucati e Nasim Haradinaj të dënohen me nga 6 vjet burgim dhe nga 100 euro gjobë.

Në gjykimin ndaj Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinaj janë dëgjuar katër dëshmitarë të prokurorisë, gjashtë të mbrojtjes së Gucatit dhe katër të Haradinajt.

Me shkrim janë paraqitur 18

dëshmi të dëshmitarëve, 12 nga mbrojtja e Gucatit dhe katër nga ajo e Haradinajt. Numri i ditëve të gjykimit ishte 31, ndërsa kohëzgjatja e procedurës paraprake ishte 12 muaj e 12 ditë. Gjatë këtij gjykimi fillimisht ishte paraqitur deklarata hyrëse nga ana e prokurorisë, ku një pjesë të deklaratës hyrëse e ka bërë edhe vetë prokurori i specializuar, Jack Smith. Pas kësaj janë dëgjuar dëshmitarët e prokurorisë, ndër të cilët ishin edhe punonjësit e Zyrës e Prokurorit të Specializuar (ZPS), Zenka Pumper, hetuese dhe Miro Jukiq, udhëheqës i ekipit për sigurinë dhe trajtimin e dëshmitarëve.

Pas njoftimit për përmbylljen e çështjes së prokurorisë mbrojtësit kanë bërë mocione për rrëzim të akuzave, por këto mocione ishin refuzuar nga trupi



gjyqës, i kryesuar nga Charles L. Smith II. Më tutje është vazhduar

me konferencë përgatitore të mbrojtjes dhe pas saj janë

mbajtur seancat ku mbrojtja janë paraqitur çështjet e tyre.

Ministri Mehaj: Kosova duhet t'i ketë 20 mijë rezervistë vullnetarë



PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, gjatë raportimit të tij para Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Kuvendit të Kosovës, ka thënë se janë duke punuar për Ligjin e ri të rezervës vullnetare ushtarake.

Mehaj ka vlerësuar se Kosova duhet t'i ketë 20 mijë rezervistë vullnetarë. Ai ka thënë se janë duke shikuar mundësinë që në shkollë të futet lënda e sigurisë, mbrojtjes dhe paqes. "Së pari ju

informoj se përmes punimeve ushtarake ndërlidhet çdo veprim me strategjinë. Përmes nevojës së ndryshimit të strategjisë së sigurisë aty është harmonizuar edhe nevoja shtetërore për shërbim ushtarak, një vlerësim që do të bëhet, por unë e kam parë të arsyeshme që si nevojë të jetë edhe Ligji për rezervë vullnetare. E shoh se në të ardhmen Kosova duhet të ketë një rezervë vullnetare prej 20

mijë personash që janë në shërbim përmes nevojave dhe t'i ketë stërvitjet e veçanta brenda vitit. Unë kam shikuar mundësinë se si është mundësia e lëndës së sigurisë, mbrojtjes dhe paqes në shkollë që të ketë një edukim prej një moshe nëpër shkollë, qysh e jep njeriu ndihmën e parë, qysh duhet të reagojë në tërmet, navigim. Të gjitha janë në harmonizim me strategjinë e sigurisë", ka thënë Mehaj.

aktakuzës ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit. Hodaj ka thënë se me këto pika të reja të aktakuzës procesi i gjykimit mund të shtyhet edhe për dy vjet. "Ata tani i kanë të gjitha të drejtat siç i kanë pasur nga fillimi. Tani ata kanë të drejtë që të kundërshtojnë këto pika të aktakuzës, të kërkojnë sqarime shtesë, të bëjnë kërkesa të ndryshme dhe kjo mendoj që i ka shtuar edhe dy vjet që për procedura. Prapë prej fillimit avokatët mbrojtës do të merren me kundërshtimin e këtyre akuzave siç i kanë bërë më herët", ka thënë Hodaj për "T7".

Më 4 nëntor të vitit 2020, ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, është arrestuar dhe dërguar në paraburgim në Gjykatën Speciale në Hagë. Për në të njëjtin destinacion, me një avion ushtarak, më 5 nëntor 2020 janë dërguar në Hagë edhe Thaçi, Veseli dhe Selimi. Që nga ajo kohë ata janë duke u mbajtur në paraburgim së bashku me Hysni Gucatin, Nasim Haradinajn, Salih Mustafën dhe Pjetër Shalën.

Ish-liderët e UÇK-së disa herë kanë bërë kërkesë për mbrojtje në liri, por kanë hasur në veshë të shurdhër nga Gjykata Speciale.



Kurti bashkëbisedoi me avokatët mbrojtës të të paraburgosurve në Hagë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bashkëbiseduar të martën me të gjithë avokatët dhe bashkavokatët e ekipeve mbrojtëse të liderëve të UÇK-së të cilët janë duke u akuzuar nga Gjykata Speciale në Hagë.

Në njoftimin e lëshuar nga zyra e kryeministrit është bërë me dije se takimi është mbajtur online dhe ka zgjatuar gati dy orë. Sipas këtij njoftimi, janë diskutuar kërkesat e ekipeve mbrojtëse për Qeverinë e Kosovës. "Takimi u mbajt si rezultat i nevojës për të diskutuar dhe adresuar kërkesat e bëra nga ekipet mbrojtëse: procesi i stërzgatur i mbajtjes në paraburgim të të akuzuarve, mosrespektimi i praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mungesa e përkthimeve

dhe, në veçanti, mosmarrja në konsideratë e okupimit dhe krimeve të Serbisë në Kosovë gjatë viteve '90. Kryeministri Kurti propozoi që takimet e tilla të vazhdojnë e të jenë të rregullta. Të gjitha ekipet u shprehën tejet mirënjohëse për mundësinë e diskutimit direkt me kryeministrin Kurti dhe shprehën falënderim për faktin që Qeveria e Kosovës po tregon interesim dhe angazhim në lidhje me procesin para Dhomave të Specializuara", ka njoftuar zyra e kryeministrit.

Kërkohej që Kadri Veseli t'i vazhdojë paraburgimi

Në një shkresë drejtuar gjykatës të procedurës paraprake, Nicolas Guillou, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka kërkuar që Kadri Veseli t'i vazhdojë paraburgimi. Sipas prokurorisë, vazhdimi i paraburgimit mbetet i nevojshëm. Ata kanë përmendur si rreziqe, rrezikun e arratisjes, pengimin e procedurave të Dhomave të Specializuara dhe rrezikun për të kryer krime të mëtejshme. Ndryshe, pas dorëzimit të aktakuzës së plotësuar nga ZPS-ja, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi do të dalin para gjykatës më 10 maj. Thaçi pritet të dalë nga ora 10:00 deri në 10:45, Veseli nga ora 11:15 deri në orën 12:00, Krasniqi nga ora 14:00 deri në 14:45 dhe Selimi nga ora 15:15 deri në orën 16:00. Po ashtu, gjykatësi paraprak Nicolas Guillou ka marrë vendim, duke ia vazhduar masën e paraburgimit Pjetër Shalës, i cili është duke u akuzuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) për krime lufte.

BE-ja i kërkon Kosovës më shumë reforma në qeverisje lokale

BRUKSEL, 4 MAJ - Komisionari i Bashkimit Evropian (BE) për zgjerim dhe fqinjësi, Oliver Varhelyi, ka njoftuar se ka biseduar me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës, Elbert Krasniqi, mbi rolin që kanë

komunat në zbatimin e planit të BE-së për ekonomi dhe investime. Ai në llogarinë e vet në "Twitter" ka treguar se BE-ja ka nisur edhe asistencën për Kosovën në këtë drejtim. "Diskutoam me ministrin e Administrimit të Pushtetit

Lokal të Kosovës, Elbert Krasniqi, për rolin e komunave në zbatimin e planit ekonomik dhe të investimeve të BE-së. Ndhimja të konsiderueshme janë rrugës. Kosova duhet të përparojë me reforma", ka shkruar Varhelyi.



Drejtoresha e Arsimit në Prishtinë: Nuk do të ketë punësime politike

PRISHTINË, 4 MAJ - Drejtoresha e Arsimit në Komunën e Prishtinës nga radhët e PDK-së, Besianë Musmurati, ka thënë se nuk do të ketë punësime politike në shkollat e kryeqytetit. Musmurati ka thënë se përzgjedhja e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve do të bëhet

në bashkëpunim me Ambasadën e Britanisë së Madhe. "Do t'u japim fund punësimeve partiake në shkollat e Prishtinës. Jam e lumtur që për herë të parë në historinë e komunës së Prishtinës, me kërkesën dhe iniciativën e Drejtorisë së Arsimit, drejtorët

dhe zëvendës drejtorët e shkollave tona, do të përzgjidhen në bashkëpunim me Ambasadën Britanike në Kosovë. Me këtë ne do të vendosim një vijë të qartë mes qeverisjes sonë në shërbim të qytetarëve dhe qeverisjeve të kaluara", ka thënë Musmurati. Ajo ka theksuar se edukimi dhe

arsimimi i fëmijëve të Prishtinës lidhet ngushtë me mënyrën e funksionimit dhe menaxhimit të shkollave. "Menaxhimi i shkollave është jetik për funksionim të mirëfilltë të arsimit. Edukimi dhe arsimimi i fëmijëve të Prishtinës lidhet ngushtë me mënyrën e

funksionimit dhe menaxhimit të shkollave dhe çerdheve. Prandaj, e konsideruam çështje të rëndësishme parësore që procesin e emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave ta bëjmë sa më transparent dhe gjithëpërfshirës", është shprehur Musmurati.



Deklarohen të pafajshëm Lekaj dhe të akuzuarit e tjerë në rastin e 53 milionë eurove



PRISHTINË, 4 MAJ - Ish-ministri i Infrastruktūrës, Pal Lekaj, dhe të gjithë të akuzuarit e tjerë në rastin e 53 milionë eurove, janë deklaruar të pafajshëm. Përveç deputetit Lekaj, të akuzuar në këtë rast janë edhe Eset Berisha, këshilltar i lartë politik i Pal Lekajt, Nebih Shatri, ish-sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Infrastruktūrës (MI) si dhe Besim

Tahiri, drejtor i Prokurimit Publik në këtë ministri. Në seancën e së martës prokurori i rastit, Valdet Gashi, ka lexuar edhe diapozitivin akuzues. Seanca e shqyrtimit të dytë fillestar është caktuar më 17 qershor në orën 10:00. Ndërsa në një afat prej 30 ditësh palët kanë të drejtë të kundërshtojnë këtë aktakuzë.

Kujtojmë se Prokuroria Speciale më 4 shkurt 2021 ka ngritur aktakuzë për Pal Lekaj dhe të tjerët se janë përfshirë në aferën korruptive kur ishte vendosur për ndarjen e 53 milionë e 100 mijë euro për "Bechtel & Enka"-n në emër të vazhdimit të punimeve në autostradën "Arbën Xhaferi" që lidh kryeqytetin me Hanin e Elezit.

Deputetët sot diskutojnë për pagën minimale

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Kuvendi i Kosovës do të mbajë sot (e enjte) seancë plenare me fillim nga ora 10:00. Në rend dite është edhe propozimi i dy kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtuese. Po në rend dite është edhe shqyrtimi i parë i

Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficentit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore dhe Projektligji nr. 08/L-143

për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Në Kuvend do të ketë edhe debat parlamentar për punën e qeverisë në vitin e parë të mandatit.



Historianët e Deçanit kërkojnë dorëheqjen e kryetares së Gjykatës Kushtetuese

“Epoka e re”

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Lidhja e Historianëve të Kosovës “Ali Hadri”, dega në Deçan, përmes një letre publike kërkojë dorëheqjen e kryetares së Gjykatës Kushtetuese Gresa Caka-Nimani.

Lidhja e Historianëve të Kosovës “Ali Hadri”, dega në Deçan, përmes një letre publike sot kërkon dorëheqjen e kryetares së Gjykatës Kushtetuese Gresa Caka-Nimani për shkak të vendimit për dhënien e pronave Manastirit të Deçanit, me çka thuhet se është krijuar precedent i rrezikshëm.

Në letër është thënë se më 20 maj 2022 bëhen plot 6 vjet qëkur Gjykata Kushtetuese, me një panel të gjykatësve vendorë, pa përfshirë gjykatësin Bekim Sejdiu që ishte kundër, dhe të tjerët që kanë abstenuar në votim dhe ndërkombëtarë, merr vendim në formë të aktgjykimit, me anë të te cilit i njeh si vendime legjitime dhe legale në Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, ligjet, vendimet dhe aktet nënligjore që ka marrë Serbia për Kosovën gjatë periudhës 1990-1999.

Gresa Caka-Nimani, kryetare aktuale e Kushtetueses dhe ish e para e Kushtetueses Arta Rama-Hajrizi, kanë qenë pro dhe bashkë me gjykatësit ndërkombëtarë të Kushtetueses kanë qenë pro kërkesës së Manastirit të Deçanit, që pronat

dhe ndërmarrjet “Apiko” dhe “Iliria” t’i falen manastirit, në mbështetje të vendimeve të kohës së masave të dhunshme të Millosheviqit, thonë historianët. Për më tepër, ata thonë se Gresa Caka-Nimani dhe Arta Rama-Hajrizi, me përkrahjen dhe votimin pro zbatimit të vendimeve të kohës së Millosheviqit në Kosovë, kanë shkelur Kushtetutën dhe rendin e ri kushtetuese në Kosovën e pasluftës. “Gresa Caka-Nimani duhet të japë dorëheqje nga detyra e saj në krye të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ngaqë aktgjykimi i kësaj gjykate për pronat në Deçan është precedent i rrezikshëm, dhe Kosovën e ka futur në një rrogë qorre, nga e cili e ka të vështirë të dalë. Gresa Caka-Nimani dhe Arta Rama-Hajrizi, me rastin e marrjes së këtij aktgjykimi para 6 vjetësh, kanë dëshmuar se për to më e rëndësishme është karrigia dhe profesioni i tyre sesa interesi i popullit dhe kombit shqiptar dhe mbrojtja e kushtetutshmërisë në Kosovë”, është thënë në letër.

Historianët e Deçanit kanë thënë se dorëheqja e Gresa Caka-Nimanit është rruga e mirë dhe do t’i bënte nder që të mos të jetë në krye të Gjykatës Kushtetuese. “Gresa Caka-Nimanin e ftojme për deklarim publik dhe të japë përgjigje se pse i ka dhënë përkrahje kësaj marrëzie, e cila krye e këput e ka bazën në ligjet e Millosheviqit. Ne e përsërisim qëndrimin tonë se zgjidhja më e



mirë për pronat dhe ndërmarrjet ‘Apiko’ dhe ‘Iliria’ është që të kthehen në pasuri (asete) shtetërore të Republikës së Kosovës”, është thënë në letër. Historianët e Deçanit edhe një herë bëjnë thirrje që të mos zbatohet aktgjykimi antikushtetues dhe antiligjor për pronat dhe ndërmarrjet “Apiko” dhe “Iliria”. “Ne, me të gjitha forcat tona, do të kundërshtojmë çdo tentim të zbatimit të vendimit tuaj, ngaqë në Kosovë nuk mund të zbatohen vendimet e Millosheviqit, vendime këto që i ka luftuar e mbarë bota demokratike dhe të cilat i ka shpallur nul misioni i UNMIK-ut në Kosovë”, është thënë në këtë letër.

Ndryshe, kryeministri Albin Kurti në shkurt të këtij viti përsëriti qëndrimin e tij se vendimi i Kushtetueses për t’i detyruar autoritetet lokale të Deçanit t’ia kthejnë Manastirit të Deçanit 24 hektarë tokë dhe pyje është i bazuar në “politikën diskriminuese” të Qeverisë së Serbisë të vitit 1997.

Ai pati thënë se qeveria do të përpiqet t’i ruajë të drejtat legjitime të Manastirit të Deçanit, por shtoi se edhe liderët fetarë duhet të kërkojnë zgjidhje përmes dialogut dhe marrëveshjes me popullatën lokale në Deçan.

Autoritetet lokale në Deçan besojnë se 24 hektarët tokë dhe pyje janë të ndërmarrjeve

shoqërore “Apiko” dhe “Iliria” dhe me këmbëngulje refuzojnë zbatimin e vendimit të Kushtetueses.

Gjykata Kushtetuese pati deklaruar se vendimi i saj nuk ishte zbatuar dhe i bëri thirrje Prokurorisë së Shtetit të Kosovës që të ndërmarrë veprime të mëtejme në përputhje me kompetencat ligjore.

Në vendimin për moszbatimin e aktgjykimit, Gjykata Kushtetuese tha se nuk ka juridiksion ta vlerësojë përgjegjësinë për moszbatimin e vendimit nga organet përgjegjëse dhe se një vlerësim i tillë i takon prokurorit të shtetit në përputhje me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.

Jep dorëheqje ministri danez që nënshkroi marrëveshjen me Kosovën për burgjet

KOPENHAGË, 4 MAJ - Kosova më 26 prill ka nënshkruar traktatin për t’ia dhënë Danimarkës me qira 300 qeli në burgun e Gjilanit. Marrëveshja është kritikuar nga disa organizata të fëmijëve në Danimarkë, të cilat ka thënë se ajo mund t’i shkelë të drejtat e njeriut. Siç shkruan mediumi danez “Altinget”, disa organizata thonë se mundësia që fëmijët t’i vizitojnë prindërit e tyre të transferuar në burgjet e Kosovës mund të komplikohet aq shumë sa mund të jetë në shkelje të të drejtave të njeriut.

Kësisoj, marrëveshja politike për dhënien me qira të burgjeve në Kosovë rrezikon t’i dëmtojë fëmijët, vlerësojnë në Danimarkë. Fëmijët kanë të drejtë t’i vizitojnë prindërit e tyre, por mund të jetë aq e shtrenjtë dhe e rëndë sa rrezikojnë ta humbasin marrëdhënien me prindërit e tyre, shkruan “Altinget”.

Marrëveshja me Kosovën është një nga veprimet e fundit të tani ish-ministrit të Drejtësisë, Nick



Hækkerup, i cili të dielën ka njoftuar për dorëheqje, duke thënë se do të merret me sfida të reja. Siç ka njoftuar vetë ai në “Facebook”, nga 1 qershori, ish-politikani i njohur social-demokrat në Danimarkë, do të jetë drejtor i Shoqatës së Birrëbërësve.

Marrëveshja e kritikuar nga disa

organizata të fëmijëve tani do të jetë në dorë të ministrit të ri, Mattias Tesfaye, të cilit i kërkohet ta konsultojë ligjin.

Këtë marrëveshje e ka lavdëruar më 27 prill në Komisionin Parlamentar për Integritet Evropian, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu. “Një marrëveshje e tillë e fuqizon

bashkëpunimin dhe, po ashtu, kemi marrë zotimet nga Danimarka që do të na ndihmojë në secilën pengesë apo barrikadë që ne e kemi si shtet në anëtarësime në mekanizma të ndryshëm, qoftë në çështjen e liberalizimit të vizave”, kishte thënë ajo, duke theksuar se “fjalën e fundit e ka Kuvendi”.

Ish-homologu i saj danez, Nick Hækkerup, po ashtu e kishte përshkruar marrëveshjen si shumë të favorshme për vendin e tij. Sipas Hækkerup, marrëveshja siguron që kriminelët e deportuar nga Danimarka të mbahen në Kosovë në burgje që i plotësojnë standardet daneze. Sipas tij, burgju në Gjilan është shumë i përshtatshëm për këtë qëllim.

Gazetat daneze kanë shkruar se marrëveshja përmban një pasazh, sipas të cilit, të dënuarit, të cilët vijnë ekskluzivisht nga vendet jashtë BE-së, duhet të deportohen drejtpërdrejt nga Kosova në vendet e tyre të origjinës pasi ta kenë vuajtur dënimin.

Marrëveshja duhet të ratifikohet nga parlamentet e Danimarkës dhe të Kosovës.

Nga kjo marrëveshje ndërkombëtare Kosova për 10 vjet pritet të përfitojë 60 milionë euro investime në energji të ripërtërishe dhe 150 milionë euro për nevojat e tjera të vendit.

Banka Botërore 'alarmon' për rënien ekonomike të Kosovës dhe shteteve të rajonit

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Rritja ekonomike e Kosovës do të ngadalësohet në vitin 2022 pas rimëkëmbjes së fortë pas pandemisë, parashikon Banka Botërore (BB) në raportin e fundit ekonomik për Ballkanin Perëndimor. Të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë duke u ballafaquar me një gamë të re sfidash ekonomike, ka thënë BB-ja, përkundër ringritjes më të mirë sesa pritej nga recesioni i shkaktuar nga pandemia Covid-19. "Ekonomia e Kosovës përjetoi një rimëkëmbje të plotë të mbështetur nga konsumi privat, rritja rekord e eksporteve, rikthimi i jashtëzakonshëm i vizitave nga diaspora, rritja e fortë e kreditimit si dhe stimujt e konsiderueshëm fiskalë. Me rimëkëmbjen e ekonomisë u përmirësua bilanci fiskal dhe u ngadalësua rritja e borxhit publik falë performancës së fortë të të hyrave publike. Megjithatë, rimëkëmbja u shoqërua edhe me presione jashtëzakonisht të larta inflacioniste, veçanërisht gjatë pjesës së dytë të vitit, të nxitura kryesisht nga rritja e çmimeve të importeve", ka njoftuar BB-ja. Banka Botërore ka theksuar se "ndikimet e zgjatura të presioneve të jashtme të kohëve të fundit mund t'i përkeqësojnë më tej perspektivat ekonomike të Kosovës". "Pengesat strukturore, siç janë kapacitetet e vjetruara të prodhimit të energjisë, e shtojnë më tej pasigurinë. Rritja në vitin

2022 pritet të ngadalësohet në nivelin mes 3 dhe 4 për qind, duke supozuar se çmimet do të normalizohen gjatë gjysmës së dytë të vitit. Investimet e vazhdueshme private dhe përsheptimi i investimeve dhe konsumit publik pritet të jenë mbështetës të rritjes. Ka nevojë urgjente për trajtimin e kufizimeve për rritjen me produktivitet më të lartë dhe për investime në kapitalin njerëzor në mënyrë që Kosova t'i shfrytëzojë avantazhet që sjell popullsia në moshë të re", citohet të ketë thënë Massimiliano Paolucci, menaxher i Bankës Botërore për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut. "Nëse Kosova nuk e forcon kapitalin e vet njerëzor, do ta ketë më të vështirë të sigurojë rritje më të shpejtë dhe më gjithëpërfshirëse, nuk do të ketë fuqi punëtore të përgatitur për punët e së ardhmes, si dhe nuk do të jetë në gjendje të konkurrojë në ekonominë globale", ka thënë ai. Risqet e rënies për perspektivën ekonomike të rajonit duken tepër brengosëse, ka vlerësuar Banka Botërore. "Zgjerimi i konfliktit ose zgjatja e luftës në Ukrainë mund të shkaktojë trazime të mëtejshme të tregtisë globale dhe çmimeve të energjisë dhe ushqimeve. Risqet e rifinancimit mund të lindin nëse vazhdojnë të shtrëngohen kushtet e tregut të jashtëm financiar. Qëndrueshmëria e borxhit mund



të kthehet në shqetësim nëse hapësira e kufizuar fiskale gërryhet nga përgjigjet e politikave ndaj rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, ndërkohë që rriten edhe kostot e rifinancimit. Në një mjedis të tillë politika e qeverisë duhet të fokusohet në ndërtimin e qëndrueshmërisë dhe në ndërmarrjen e reformave strukturore për ta mbështetur rritjen dhe për ta gjetur drejtimin përgjatë krizave", citohet të ketë thënë Sanja Madzarevic-Sujster, ekonomiste e lartë e Bankës Botërore dhe një nga autorët kryesorë të raportit. "Duke pasur hapësirë të kufizuar fiskale, vendet do të duhet t'i peshojnë me kujdes kostot dhe përfitimet e zotimeve të reja për shpenzime në përgjigje ndaj rritjes së

çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, duke u dhënë përparësi familjeve më të cenushme", citohet të ketë thënë ajo. Në kontekstin e krizës energjetike në Evropë, raporti ofron një vlerësim të cenusshmërisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor ndaj goditjeve prej çmimeve të energjisë, masave të marra nga qeveritë për t'i zbutur ndikimet, dhe si mund të ndikojë kriza në ecjen përpara me tranzicionin e energjisë së gjelbër. "Për t'iu përgjigjur krizës aktuale energjetike dhe për ta garantuar mbrojtjen e amvisërive dhe firmave më të cenushme, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk duhet t'i harrojnë synimet e tyre afatgjata për ta arritur sigurinë energjetike dhe

reziliencën si pjesë e agjendës së reformës së gjelbër", shton Richard Record, kryekonomist i Bankës Botërore dhe një nga autorët kryesorë të raportit. Raporti i BB-së ka argumentuar se rritja e qëndrueshme nuk mund të ndodhë pa reforma strukturore që shtojnë produktivitetin, rrisin konkurrencën, investojnë në kapitalin njerëzor dhe forcojnë qeverisjen. Masat për uljen e kostove rregullatore të biznesit, për rritjen e konkurrencës në treg, për mbështetjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe për forcimin e pavarësisë së institucioneve publike do të ishin të gjitha mbështetëse për rritjen në një mjedis të pasigurt. "Rritja e BPV-së në rajon kapi nivelin prej 7.4-përqindësh në vitin 2021, pas tkurrjes prej 3.2-përqindësh në vitin 2020. Ky kthim në rritje solli hapje të konsiderueshme të vendeve të punës dhe kërkesa për punësim ndihmoi në uljen e varfërisë në të gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor. Në vitin 2021 shkalla e punësimit në Ballkanin Perëndimor kapi nivelin më të lartë historik prej 45.8-përqindësh. Megjithatë, rimëkëmbja pas pandemisë u ndërpre nga valët e tronditjeve që lufta në Ukrainë ka dërguar në mbarë rajonin", ka njoftuar Banka Botërore. Sipas këtij institucioni, tashmë rritja për Ballkanin Perëndimor parashikohet të jetë 3.1 për qind në vitin 2022.

PDK-ja: Në mars Kosova importoi 0.56 për qind energji, por qytetarët vazhdojnë të paguajnë me rritje

PRISHTINË, 4 MAJ - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e ka cilësuar sërish të padrejtë vendimin e Qeverisë së Kosovës për rritje të çmimit të energjisë elektrike. Nënkrjetari i kësaj partie, Uran Ismaili, në një konferencë për medie ka thënë se ky vendim ka qenë i panevojshëm dhe është e pakuptimtë që qytetarët t'i paguajnë faturat e energjisë elektrike me rritje kur ka prodhim të mjaftueshëm të energjisë për nevojat e konsumit të brendshëm. "Sot jemi këtu për të paraqitur dhe për të zbërthyer këto fakte dhe kemi marrë si shembull muajin mars kur qytetarët tanë kanë paguar energjinë elektrike me 100 për qind rritje. Prodhimi i energjisë ka mbuluar kërkesën e konsumit. Madje vetëm gjatë muajit mars, sipas shifrave që po i shihni, Kosova ka prodhuar 170 mijë megavat më shumë sesa kërkesa e konsumit. Ndërkaq, ka importuar vetëm 0.56 për qind energji elektrike", ka thënë ai. Ismaili ka thënë se qeveria ka thënë se është thënë se kriza ka ndodhur për shkak të importit të madh, por faktet tregojnë se Kosova nuk ka pasur krizë

energjetike. "Ngritja e çmimit të energjisë elektrike i ka vënë qytetarët tanë para një dileme të madhe se ku duhet ndarë buxhetin familjar, a duhet të shkojë në produktet bazike të cilat janë shtrenjtuar, a duhet ta paguajë faturën apo të hyjnë në borxhe familjare për ta mbuluar muajin. Ky vendim me të cilin qytetarët tanë janë dëmtuar financiarisht ka qenë i padrejtë, i panevojshëm dhe faktet sot tregojnë që ne nuk kemi pasur nevojë fare ta ngrehim çmimin e energjisë", ka thënë Ismaili. Ndërsa deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha, ka rikujtuar se qeveria Kurti, pas shumë vitesh ka kthyer reduktimet e rrymës, duke mos ndërmarrë hapa me kohë karshi të ashtuquajturës krizë energjetike. "E them kështu, të ashtuquajturën, sepse ironia qëndron në faktin e numrave të prezantuar nga kolegët e mi edhe në Kuvend, edhe në konferencat e kaluara për shtyp lidhur me këtë çështje ku shihet qartë se në muajin shkurt ka pasur mjaftueshëm prodhim nga brenda për t'i mbuluar nevojat e konsumit dhe se importi ka qenë në përqindje shumë të vogël,



përderisa qytetarët kanë paguar faturën e shkurtit me çmimin e rritur. Dhe të mos harrojmë që është kalkuluar nga gjysma e muajit sipas vendimit të ZRRE-së. Dhe duke pasur konsum mjaftueshëm, sërish në Kuvend vjen kërkesa për vazhdimin e gjendjes emergjente. Pra, kjo është ironia", ka thënë Hoxha. Në këtë kontekst, Hoxha ka thënë se PDK-ja ka iniciuar themelimin

e Komisionit Hetimor për Energjinë, të cilin, sipas saj, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje po tentojnë ta pamundësojnë. Ajo ka thënë se në rastet kur kërkesa për themelimin e një komisioni hetimor vjen nga 1/3 e deputetëve, Kuvendi detyrimisht në seancë plenare duhet ta themelojë komisionin. "Pra, që të jemi të qartë, ky komision tashmë me Kushtetutë dhe me Ligjin për Hetim Parlamentar duhet të

cilësohet si i themeluar. Në të kundërtën çdo përpjekje për ta penguar dhe parandaluar themelimin e këtij Komisioni Hetimor përbën shkelje kushtetuese dhe cenim të demokracisë në vend. Kjo është hera e parë që në historinë parlamentare të pengohet themelimi i një komisioni hetimor, por kjo nuk është hera e parë që kjo qeveri e shkel Kushtetutën", ka theksuar Hoxha.

Ani Kokobobo: Si të lexosh Tolstoin dhe Dostojevskin kur Rusia lufton kundër Ukrainës

Përktheu nga rusishtja:
BUJAR HUDHRI

Kur jep mësim letërsinë ruse, madje në këtë kohë, kur kultura ruse në krejt botën “po hiqet”, vazhdon ta perceptosh botën përmes prizmit të romaneve, tregimeve, vargjeve dhe pjesëve të krijuara nga shkrimtarët rusë. Kur ushtria ruse kryen akte të panumërta dhune në Ukrainë, kur ndeshesh edhe me shembuj të një ashpërsie barbare, të tillë si vrasjet e banorëve paqësorë në Buça, diskutimi se si të sillemi me letërsinë ruse është kryekrejt i ligjshëm. Nuk shqetësohem se në njëfarë mënyre mund të shmangim veprat e shquara të artit. Ato vepra, të cilat e kanë kapërcyer kohën e tyre dhe mbeten aktuale për brezat e rinj gjithmonë, që pasardhësit përmes prizmit të tyre mund t'i shohin në mënyrë kritike problemet e realitetit që i rrethon. Me këtë cilësi janë pajisur të gjitha veprat e mëdha të letërsisë ruse, por, si studiuese e krijimtarisë së Tolstoit dhe Dostojevskit, dëshiroj të ndalem pikërisht tek trashëgimia e këtyre shkrimtarëve më të njohur rusë përtej kufijve.

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, kritiku gjerman Theodor Adorno e përshkroi Holokaustin si një disfatë globale të kulturës dhe filozofisë perëndimore, madje shkoi aq larg sa shtroi pyetjen: a mund të kishin aftësinë qeniet njerëzore “të jetonin pas Auschwitz-it”? Ky mendim ka lindur në një kontekst të veçantë të Holokaustit dhe nuk mund ta përdorim assesi për situatën e sotme. Por, duke medituuar për moralin që e udhëheq Adorno, nuk mund të mos mendoj se si mizoria në Buça dhe shembujt e tjerë të ashpërsisë barbare të luftëtarëve rusë në Harkov, Mariupol, në rrethinat e Kievit po ndikojnë në perceptimin tonë për letërsinë ruse.

PËRBALLIMI I VUAJTJES ME SYTË ÇELUR

Kur mësoi se shkrimtari rus Ivan Turgenev kishte kthyer kokën menjëherë në çastin e fundit, duke qenë dëshmitar i një ekzekutimi me vdekje, Dostojevski shprehu qartësisht pozicionin e tij në këtë rast: “Njeriu mbi këtë tokë nuk ka të drejtë të kthejë shpinën dhe të injorohet se çfarë po ndodh në tokë, dhe ka arsye të larta morale për këtë.”

Në romanin *Vëllezërit Karamazov* më 1880, Dostojevski në mënyrën më radikale vendosi para lexuesit dilemën morale të vuajtjes së fëmijëve. Kur lexon se si banorët e Mariupolit kanë vuajtur urie prej bombardimeve të artilerisë ruse, kur sheh rrënojat e teatrit mariupolas, në bodrumet e të cilit u strehuan fëmijët prej bombave, do të më interesonte të merja vesh se çdo të thoshte me këtë rast Dostojevski. Fjala “fëmijë” ishte



shënuar në trotuarin pranë teatrit me germa kapitale që të mund të lexohet qartë nga ajri, ndaj nuk mund të kishte keqkuptime se kush ndodhej në ndërtesë.

Për Ivan Karamazovin, heroin kryesor të romanit të Dostojevskit, ideja kristiane e faljes dhe e pajtimit nuk quhet përgjigje bindëse për pyetjen morale të përgjegjësisë për të keqen. Në diskutime me heronj të tjerë Ivani shpesh sjell shembuj të traumatizimit të fëmijëve, duke i detyruar kësaj bashkëbiseduesit të pranojnë dhe të kuptojnë faktet e mizorive, çka do të na çonte në rishqyrtimin e vetë bazave të sistemit etik. Pa dyshim, Dostojevski po ashtu nuk do të mund t'i shmangej faktit të bombardimit të qëllimshëm të fëmijëve në Mariupol. A do të mundej ai të vijonte të mbronte idenë e ligjit natyror moral të njeriut rus pas ngjarjeve në Buça, kur të shihet kufomat e pafajshme të burrave, grave dhe fëmijëve?

Ndërkohë, lexuesit nuk duhet të mbyllin sytë në anët e shëmtuara të filozofisë së Dostojevskit, në idenë e tij “të Rusisë së zgjedhur”. Dogma për Rusinë e madhe dhe mesianizmin rus, që promovoi Dostojevski, është e lidhur me shumë rryma globale ideologjike, të cilat justifikuan veprimet kolonizuese të Rusisë në të shkuarën. Kjo dogmë justifikon edhe politikën e sotme të jashtme të Rusisë, duke përfshirë realizimin në praktikë të kësaj politike në Ukrainë. Megjithatë, Dostojevski ka qenë edhe një mendimtar-humanist i shquar, ideja e tij për Rusinë e madhe është e pandashme nga refleksat e vuajtjeve dhe besimit rus. Natyrisht, për njeriun që u internua për pesë vjet në Siberi vetëm se kishte marrë pjesë në një klub libri që glorifikonte socializmin, do të ishte e natyrshe t'i vishte çdo vuajtjeje një vlerë shpirtërore. Personaliteti i Dostojevskit u formua nën ndikimin e përvojës vetjake, por e pamundur që justifikimi i vuajtjes për të do të përhapej në një terror, të organizuar nga shteti.

Në *Krim e ndëshkim* Dostojevski përshkruan me detaje taksën e krimit për vetë kriminelin. Sipas tij, vrasësi, pasi ka marrë jetën e huaj, pashmangshmërisht vret me këtë rast edhe një pjesë të vetes. A do ta pranonte Dostojevski vizionin

putinist të Rusisë? Do ta tmerronin ngjarjet në Ukrainë më të madhin rebel metafizik të Rusisë Dhe kryesorja, a do të protestonte kundër dhunës ruse mbi Ukrainë? Shpresoj që do të bënte po ashtu si shumë shkrimtarë bashkëkohës rusë. Por propagandën e Kremlinit – e përhapur gjithandej – shumë rusë e kanë bërë pjesë të tyre. Në Rusi, po ashtu, ka jo pak nga ata që thjesht e injorojnë se çfarë po ndodh në vendin fqinj.

SHTEGU I TOLSTOIT DREJT PACIFIZMIT

Nuk ka shkrimtar që do të reagonte më ashpër ndaj militarizmit sesa Tolstoi, njeri i cili në përvojën e tij ka njohur fatin e ushtarit, duke mbetur pacifist i përhershëm. Në veprën e tij të fundit, në novelën *Haxhi Murati*, Tolstoi kritikon rreptë ekspansionin kolonial të Rusisë në Kaukazin Verior, duke rrëfyer se si dhuna e pamëshirshme mbi çecënët do të çonte menjëherë në urrejtjen për pushtuesin.

Në kohën e të gjitha luftërave, pa përjashtuar edhe botëroren e dytë, në Rusi bëhej rileximi i romanit më të njohur të Tolstoit, *Lufta dhe paqja*. Aty Tolstoi pohon se kyçi i fitores në luftë është morali i ushtrisë ruse. Kur ushtarët mbrojnë tokën e tyre, atëherë ata kanë më shumë shanse për fitore, sepse ushtarët e kuptojnë përse po luftojnë dhe çfarë po mbrojnë. Madje, edhe kur përshkruan luftimet mbrojtëse, Tolstoi tregon besnikërisht përjetimet e mundimshme të ushtarëve të rinj në moshë, të cilët ndeshen ballë për ballë me makinën e vdekjes. Ata humbasin në turmën e batalionit, por, në fund të fundit vdekja e një ushtari tregohet si një pikëllim i pangushëllueshëm për familjen, që mezi pret kthimin e tij në shtëpi.


Pas botimit të romanit *Lufta dhe paqja*, Tolstoi dënoi publikisht shumë fushata luftarake ruse. Pjesa e fundit e *Ana Kareninës* fillimisht nuk u botua për këtë arsye, sepse në roman kritikoheshin veprimet e Rusisë në luftën e radhës rusoturke. Heroi i romanit, Konstantin Levini, prototipi i të cilit, sikundër thuhet, ishte vetë Tolstoi, e quan hyrjen e Rusisë në këtë luftë si “një masakër” dhe nxjerr verdiktin: njerëzit rusë nuk duhet të marrin pjesë në të. “Populli sakrifikon dhe

është gati të sakrifikojë për shpirtin e tij dhe jo për të vrarë”, – shprehej Tolstoi.

Në vitin 1904 Tolstoi shkroi një letër të hapur duke dënuar luftën ruso-japoneze: “Përsëri luftë. Përsëri vuajtje që askujt nuk i nevojiten, nuk i kërkon kush, përsëri gënjeshtëri, përsëri idiotësi e përgjithshme, brutalizim i njerëzve.” Vetë titulli i kësaj letre – *Thirrini mendjes!* – tingëllon si një britmë që Tolstoi ua drejton bashkatdhetarëve të tij sot.

Librat e Tolstoit dhe Dostojevskit nuk mund t'i ndalojnë veprimet e ushtrisë ruse në Ukrainë, por ata në njëfarë mase janë ngulitur në të kulturën ruse dhe ka shumë rëndësi se si ata lexohen sot. Në një nga tekstet pacifiste më të njohura të tij, në esenë e vitit 1900 *Mos vrit*, Tolstoi ka diagnostikuar saktësisht problemin e Rusisë së sotme: “Mjerimi i njerëzve vjen jo nga persona të veçantë, por nga ajo strukturë e tillë e shoqërisë, nën të cilën të gjithë njerëzit janë aq të lid-

ria ruse nuk e quante të nevojshme të kujdesej. Ai u përpoq t'u ndihmojë atyre rusëve, të cilët shmangeshin nga detyrimi ushtarak, vizitonte në burgje të arrestuarit pse nuk donin të luftonin. Paratë e fituara nga shitja e romanit *Ringjallja* Tolstoi i shpenzoi në ndihmë të pjesëtarëve të sektit të krishterë duhobor (një sekt pacifist, fetar, që lindi në Rusinë e shekullit XVIII – shën. i përkth.), të cilët përpqeshin të emigronin në Kanada, për t'i shpëtuar detyrimit që të luftonin në radhët e ushtrisë ruse. Këta dy shkrimtarë pak gjëra të përbashkëta kanë me ideologjinë e justifikimit të luftës së sotme. Ata nuk mund të ndalojnë apo të zbusin veprimet e ushtrisë ruse në Ukrainë, por në njëfarë mase të ngulitur në kulturën ruse dhe i japin një kuptim se si librat e Dostojevskit dhe Tolstoit lexohen sot. Jo sepse letërsia klasike ruse mund të shpjegojë se çfarë po ndodh sot – ajo nuk ka forcë ta bëjë këtë. Por sepse,



hur me njëri-tjetrin, sa të gjithë ndodhen në pushtetin e disa njerëzve, ose, më shpesh, të një njeriu, i cili ose të cilët janë kaq të mbrapshtë me këtë pozitën e tyre të panatyrshme si arbitër të fatit dhe jetës së miliona njerëzve, i cili kurdoherë ndodhet në një gjendje të sëmurë dhe kurdoherë vuan shumë apo pak prej manisë së vetëmadshtisë.”

RËNDËSIA E AKSIONIT

Nëse Dostojevski e quan të drejtë të mos e injorosh të keqen dhe padrejtësinë, atëherë Tolstoi u bën thirrje njerëzve të veprojnë, duke u nisur nga ajo se çfarë kanë parë. Në kohën e urisë ruse 1891-1892 Tolstoi organizoi shpërndarjen e supës fshatarëve, për të cilët qeve-

sikundër ka shkruar një shkrimtar ukrainas, Sergej Zhadan, lufta kundër Ukrainës shënoi në vetvete disfatën e traditës humaniste ruse. Kjo kulturë po pajtohet me ato që ushtria ruse pa dallim bombardon dhe asgjëson ukrainasit. Kështu që shkrimtarët e shquar rusë duhen lexuar në mënyrë kritike, me synimin se si të ndalohet dhuna. Lideri i opozitës ruse Aleksej Navalni ka shkruar që Tolstoi u kishte bërë thirrje bashkatdhetarëve të luftojnë despotizmin dhe luftën, sepse njëra pjell tjetren. Kurse artistja ukrainase Alevtina Kahidze ka cituar romanin *Lufta dhe paqja* në ditarin e saj grafik: “E kam lexuar letërsinë tuaj artistike. Ka të ngjarë që Putini nuk e ka lexuar dhe ju e keni harruar.”

Demonstratat e vitit 1981 sipas dokumenteve britanike



Shkruan: Prof. dr. Sabit SYLA

Në fillim të dekadës së tetë të shekullit njëzet, kur Lufta e Ftohtë midis Lindjes dhe Perëndimit, apo midis shteteve komuniste të prira nga Bashkimi Sovjetik dhe demokracive perëndimore nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishte gjithnjë e më e ashpër, dy ngjarje me rëndësi, vdekja e liderit suprem jugosllav, Josip Broz Tito dhe demonstratat shqiptare të vitit 1981 në Kosovë, e vunë ish-Republikën Federative të Jugosllavisë në qendër të interesimit publik dhe politik ndërkombëtar. Jugosllavia, si një shtet që kufizohej me vende që bënin pjesë në dy blloqet rivale, paraqiste rëndësi specifike sepse paqëndrueshmëria e saj do t'i përfshinte pa asnjë dyshim edhe shtetet fqinje, e me këtë edhe blloqet rivale. Perëndimi druante se, rivendosja e ndikimit politik sovjetik në Jugosllavi, do të rezultonte me ndryshimin e politikës së jashtme jugosllave. Në rrethana të tilla, ngjarjet në Jugosllavi u ndoqën me një kujdes të theksuar. Një qasje të tillë e ndoqi edhe Britania e Madhe, si njëra nga aleatet më të fuqishme në bllokun e demokracive perëndimore. Kjo dëshmohej nga një korrespondencë e dendur në zinxhirin e diplomacisë britanike, që përfshiu, krahas relacionit Londër-Beograd, edhe relacione tjera si Londër-Athinë, Ankara, Moskë, Vjenë, etj. Prandaj punimi "Demonstratat e vitit 1981 sipas dokumenteve britanike" synon t'i shtjellojë zhvillimet në Kosovë, respektivisht demonstratat e vitit 1981, nga optika e diplomacisë britanike. Si i vështruan britanikët këto ngjarje, si i interpretuan kërkesat shqiptare, a ishin të ndikuara nga jashtë këto zhvillime, marrëdhëniet Shqipëri-Jugosllavi, dhe nacionalizmi shqiptar në Jugosllavi, janë disa nga çështjet kryesore që do të shtjellohen bazuar në materiale të vjela nga arkivat britanikë, të cilat për shkak të kufizimeve kohore të lëndës arkivore nuk kishin qenë më parë në dispozicion të studiuesve.

Në fillim të viteve '80-të bota hyri në një fazë të re të Luftës së Ftohtë, që u karakterizua nga ngritja e tensioneve midis bllokut të vendeve komuniste të

prira nga Bashkimi Sovjetik dhe demokracive perëndimore të prira nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që ndryshe u njoh si lufta midis Lindjes dhe Perëndimit. Një ngritje e tensioneve midis blloqeve ishte rezultat i ndryshimeve në udhëheqjen më të lartë të koalicionit të demokracive perëndimore. Në ShBA zgjedhjet presidenciale të vitit 1980 i kishte fituar Ronald Regan, i cili shprehu një qëndrim për një ballafaqim pa kompromis kundër komunizmit, respektivisht Bashkimit Sovjetik, duke e quajtur atë si një "perandori e ligë".

Në kursin e ri politik kundër komunizmit, Regani pati mbështetjen e fuqishme të aleates së saj më të ngushtë, Britanisë së Madhe. Margaret Thatcher, e cila në vitin 1979 kishte marrë përsipër drejtimin e qeverisë britanike, ishte "instinktivisht e orientuar kah Atlantiku" dhe ishte e bindur, sikurse presidenti Regan, se Perëndimi mund dhe duhet të përdorë forcën kundër çdo lëvizjeje apo qeverie komuniste, ose të ngjashme, të cilat do të mund t'i rrezikonin seriozisht interesat e Perëndimit.

Një qasje e tillë shënonte periudhën kur Britania e Madhe kishte filluar ta orientonte fokusin e saj politik drejt Evropës, prandaj në orbitën e luftës kundër Bashkimit Sovjetik një vëmendje e theksuar i ishte kushtuar edhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, si njëra nga shtetet komuniste që nuk ishte anëtare e bllokut komunist. Interesimi për Jugosllavinë buronte nga fakti i pozitës së saj gjeografike, i kapaciteteve ekonomike dhe përbërjes së saj shumetnike. Njëri nga ambasadorët e Britanisë së Madhe në Beograd gjatë epokës së Titos, e kishte përshkruar këtë të fundit si një lider pragmatik autoriteti i të cilit ndikonte në arritjen e kompromiseve dhe të ndërmjetësimit midis forcave oponentë brenda shtetit shumetnik. Tek blloku Perëndimor, më saktësisht tek administrata e ShBA-së, që përfaqësonte bllokun e demokracive perëndimore, ekzistonte bindja se vdekja e Titos do t'i ofronte mundësinë Bashkimit Sovjetik që ta rivendoste ndikimin e tij në Jugosllavi, apo ta përmbyste garniturën politike jugosllave e me këtë të ndryshonte edhe orientimet në politikën e jashtme jugosllave. Prandaj, në frymën e një qëndrimi të tillë, kah pjesa e tretë e shtatorit të vitit 1980 kryeministrja britanike, Margaret Thatcher, zhvilloi një vizitë zyrtare në Jugosllavi. Ajo u bëri me dije zyrtarëve më të lartë jugosllavë rëndësinë që Britania e Madhe i

kushtonte unitetit, pavarësisht dhe integritetit territorial të Jugosllavisë.

Në frymën e një qëndrimi të tillë Britania e Madhe ndoqi zhvillimet e brendshme në Jugosllavi, gjegjësisht edhe demonstratat shqiptare të pranverës së vitit 1981. Kështu, në një raportim përmbledhës, duke u bazuar kryesisht në burimet informative jugosllave, ambasadori britanik në Beograd, E. Bolland, njoftonte Ministrinë e Jashtme britanike se në orët e vonshme të pasdites së 11 marsit 1981 në Mensën e Studentëve në Prishtinë kishte shpërthyer një revoltë në shenjë pakënaqësie me kushtet e ushqimit. Flakja e tabakut me ushqim nga një student nuk e kishte nxitur revoltën, por ajo ishte nderur më pas nga tridhjetë studentë tjerë, të cilët filluan ta demolonin Mensën. Si pasojë e revoltës u formua një turmë prej rreth 400 studentësh të cilët vërshuan rrugët e qendrës së qytetit të Prishtinës duke brohoritur kërkesa politike, ku u përplasën me policinë. Policia arriti ta shtypte demonstratën dhe t'i kthente studentët prapa në konvikte. Në përpjekje për t'i qetësuar studentët dhe për të diskutuar për përmirësimin e kushteve, më 26 mars 1981 u mbajt një takim midis stafit drejtues të Universitetit dhe studentëve. Por, takimi u ndërpre sapo studentët parashtruan kërkesa politike. Demonstratat rifilluan mu në këtë pikë kur demonstruesit nxorën flamujt e bërë gati dhe thirrën me zë të lartë kërkesa politike. Studentët u ballafaquan me policinë kur ata tentuan të dilnin në qytet ku ishin mbledhur rreth 400 000 njerëz për të përcjellë kalimin e stafetën e përvitshme të rinisë nëpër Kosovë. Policia u përgjigj ashpër dhe si rezultat disa demonstrues u plagosën, të tjerë u ndaluan dhe u plagosën. Demonstratat filluan të marrin një karakter më serioz më 1 prill 1981, kur studentëve filluan t'i bashkoheshin nxënësit e shkollave të mesme. Në raportin e tij lidhur me demonstratat, ambasadori britanik në Beograd citonte një dëshmitar okular britanik, i cili kishte theksuar se dhuna kishte filluar atëherë kur me studentët u bashkuan punëtorët, dhe kur demonstruesit filluan të thyenin xhama të dritareve dhe t'i vinin flakën makinave gjatë marshimit drejt ndërtesës së Komitetit Krahinor. Këtu, rreth orës 15:00, rreth 600-800 vetë valëvitnin flamuj, brohoritnin parulla, të cilat qarkullonin në formë letre, të tilla si: "Kosova Republikë", "Jemi shqiptarë, jo jugosllavë", "Nuk e duam kapitalizmin, e duam socializmin", "Poshtë revizionizmin", "Duam Shqipërinë e bashkuar", etj. U vlerësua se në këto demonstrata

kishin marr pjesë rreth 3 000 -4 000 shqiptarë prej të cilëve rreth 2 700 studentë. Shtypja e demonstratave të kësaj dite rezultoi me 18 demonstrues të plagosur.

Duket se demonstratat e marsit në Kosovë i kishin zënë të papërgatitur jo vetëm udhëheqjen komuniste kosovare e jugosllave, por edhe përfaqësuesit e komunitetit diplomatik ndërkombëtar të akredituar në Beograd dhe qytete tjera. Kështu, gjatë marsit diplomatët britanikë në Beograd ishin kufizuar vetëm në ndjekjen e zhvillimeve në Kosovë, duke menduar se ato ishin demonstrata spontane që do të menaxhoheshin lehtë nga udhëheqja jugosllave, parullat, kërkesat dhe serioziteti ndikuan që gjatë prillit e më tej, këta diplomatë të angazhoheshin të kuptonin esencën e këtyre demonstratave. Në krye të një misioni të tillë u vu vetë ambasadori britanik në Beograd, Sir Edwin Bolland, që shërbeu në Beograd gjatë viteve 1980-1982, i njohur për ekspertizën e tij lidhur me zhvillimet në botën komuniste. Ai ishte takuar personalisht me figura të larta politike në Jugosllavi. Në raportin e tij që mbante datën 6 prill 1981, ai shënonte se anëtar i Kryesisë së Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, Gerlickovi, i kishte thënë se demonstratat ishin pasojë e kushteve sociale dhe ekonomike që u shfaqën në Kosovë. Por, Gerlickovi nuk kishte harruar t'ia atribuonte frymën irredentiste demonstratave shqiptare, të frymëzuara nga jashtë. Kërkesa për Republikë përfshinte edhe shqiptarë në Jugosllavi, si fazë kalimtare drejt bashkimit me Shqipërinë. Por, po në të njëjtin raport, Bolland vinte në dukje se udhëheqja e lartë jugosllave nuk kishte prova për përfshirjen e sovjetikëve në organizimin e demonstratave, kurse po ashtu e dinin se udhëheqësi i Shqipërisë, Enver Hoxha, ishte në gjendje të dobët shëndetësore dhe se kishte vështirësi të brendshme.

Në një raport tjetër të Bollandit pasqyrohet mbledhja e përbashkët e Kryesisë federale dhe Kryesisë së Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, e mbajtur më 2 prill 1981, lidhur me zhvillimet në Kosovë. Konkluzionet e dala nga një takim e cilësonin të rrezikuar integritetin territorial të Jugosllavisë nga bashkëveprimi i organizuar i "armikut të brendshëm me atë të jashtëm". Këto konkluzione u përfunduan një ditë më pas, kur zyrtari i lartë partiak dhe federativ, Fadil Hoxha, para aktivistëve të partisë në Prishtinë, duke i përshkruar demonstratat si kundërrevolucionare, situatën

në Kosovë e ndërliidi me një kontekst më të gjerë, duke theksuar se në rrethanat e rënduara politike ndërkombëtare "ishte e qartë se nuk ishte në interesin e disa që Jugosllavia të ishte e qëndrueshme", dhe se "nacionalizmi e shovinizmi" në Kosovë ishin në frymën e koncepteve majtiste dogmatike që nuk ndryshonin nga parullat e euforisë informbyroistë.

Mbledhja dhe konkluzionet e cekura më lart si dhe masat e ndërmarra ishin përgjigje ndaj demonstratave të datës 2 prill 1981 kur demonstruesit në Prishtinë brohoritnin "Jemi fëmijë të Skënderbeut, ushtarë të Enver Hoxhës". Demonstrata kishte edhe në Podujevë, Vushtrri, Lipjan, Gjilan, Drenas e Gjakovë. Një ndër masat e ndërmarra ishte ndalim-qarkullimi në qytetet e cekura nga ora 20:00 deri në ora 05:00 dhe ndalim grumbullimi i më shumë se pesë personave në vende publike, ndërsa Komiteti për Mbrojtje Popullore nënshkroi një urdhër për të rrethuar Prishtinën me tanke. Për të ndihmuar shtypjen e demonstratave në Kosovë arritën forca tjera policore nga republikat jugosllave dhe Vojvodina. Situatë më alarmante ishte në Podujevë, dhe vetëm pas përforcimeve të shtuara forcat policore arritën të depërtonin në qytet, ndërsa demonstruesit dogjën 34 shtëpi të serbëve e malazezëve. Padyshim se informacioni mbi djegien e shtëpive serbe e malazeze ishte sajuar nga propaganda e gazetave serbe, pre e të cilave ishin sidomos pjesëtarët e komunitetit ndërkombëtar në Jugosllavi e në këtë rast edhe ato britanike. Propaganda serbe synonte që demonstratave t'i jepte një karakter tjetër, në mënyrë që t'i shtrembëronte kërkesat e vërteta të shqiptarëve. Demonstratat shqiptare nuk ishin të orientuara kundër ndonjë etnie tjetër, ato ishin thjesht kërkesa për avancimin e statusit juridik të Kosovës dhe për barazi me popujt tjerë në Jugosllavi.

Demonstratat vazhduan edhe më datë 3 dhe 4 prill 1981. Sipas informacioneve të pranuara demonstruesit në Ferizaj thyen xhamat e dyqaneve dhe dëmtuan rënd Hotel Lubotenin, kurse bërtitën "Nuk duam që fëmijët tanë të rrihen nga policët jashtë krahinës", "Nxirrni shokët tanë nga burgu", "Tanket jashtë krahinës", etj. Situatë e rënduar ishte edhe në Mitrovicë, ku 80 punëtorë braktisën vendet e tyre të punës dhe u bashkuan me demonstrues duke brohoritur "Trepça punon për Serbinë", "Rroftë Kosova Republikë" etj. Në rrethana të tilla, kur gjendja politike dhe e sigurisë ishte

seriozisht e rënduar, një rëndësi të veçantë për diplomatët britanikë në Jugosllavi paraqiti prononcimi zyrtar i Stane Dollancit, njëri nga bashkëpunëtorët e Titos dhe ministër federal i Punëve të Brendshme gjatë viteve 1982-1984. Në konferencën për shtyp të datës 6 prill 1981, Dollanci bëri përshkrimin më të detajuar të ngjarjeve në Kosovë. Ajo që vihej në pah ishte se Dollanc fliste për një lidhje midis grupeve nacionaliste në Kosovë me qarqe të caktuara emigrantësh jashtë vendit, në veçanti me një grup në Shtutgart dhe një në Bruksel, të cilat i përshkroi si “profashistë apo informbyroistë”. Ai vlerësoi se në demonstrata kishin marr pjesë rreth 2 000 demonstrues, prej të cilëve 200 kishin prirje të dhunshme. Dollanc mohoi përfshirjen e ushtrisë jugosllave në shtypjen e demonstratave, kurse si pasojë e ngjarjeve kishte 11 viktima, nga të cilët 9 demonstrues dhe 2 anëtarë të forcave të sigurisë.

Lidhur me Shqipërinë, Dollanc shprehu besimin se nuk mund të thoshte se qeveria shqiptare qëndronte pas këtyre ngjarjeve, duke shpresuar se Shqipëria do të vazhdonte të ndiqte politikën e Enver Hoxhës në interes të pavarësisë, integritetit dhe qëndrueshmërisë së kufijve të Jugosllavisë. Për më tepër, ai e vlerësoi kundërkushtetues dhe të pamundur krijimin e republikës së Kosovës, sepse në një rast të tillë do të shpërbëhej Jugosllavia, ndërsa e shihte të dobishëm vazhdimësinë e lidhjeve kulturore midis Kosovës dhe Shqipërisë.

Pavarësisht prononcimeve të Dollancit lidhur me Shqipërinë, megjithatë qarqet jugosllave ngjarjet në Kosovë ia atribuonin nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar dhe ndikimit të Shqipërisë. Në raportin e ambasadorit Bolland, të datës 9 prill 1981, vihen në dukje ballafaqimet midis shtypit të Tiranës (gazeta “Zëri i popullit”) dhe atij të Prishtinës (gazeta “Rilindja”). Ndër të tjera ai vuri theksin edhe tek mbështetja e “Zërit të popullit” për ngritjen e Kosovës në statusin e Republikës në kuadër të Federatës, gjë që për “Rilindjen” ishte një element për të dyshuar se Shqipëria është “kazani apo një nxitëse e tendencave të tilla armiqësore”. Duke pasur parasysh se në sistemet komuniste shtypi ishte një nga mekanizmat e pushtetit, atëherë nuk ka asnjë dyshim se përshkrimi i qëndrimeve të tilla është pasqyrimin i perceptimeve të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë, të transmetuara përmes këtij mekanizmi.

Ndonëse polemikat Shqipëri-Jugosllavi vazhdonin përmes mjeteve të shtypit, diplomatët britanikë në Beograd kishin vënë re se raportet ekonomike dhe ato kulturore shqiptaro-jugosllave vazhdonin normalisht. Oda jugosllave e ekonomisë vlerësoi se volumi i tregtisë dypalëshe këtë vit do të arrinte shifrën prej 135 milionë

dollarësh, 15 milionë më tepër se sa në vitin paraprak, ndërsa gjatë prillit të vitit 1981 u lidhën marrëveshje të bashkëpunimit kulturor-shkencor midis Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe Shqipërisë e Maqedonisë. Një qasje e tillë nga dy vendet jep të kuptohet se dyja vendet kishin nevojë për stabilitet dhe këtë stabilitet tentonin ta ruanin përmes marrëdhënieve tregtare dhe kulturore-shkencore. Në rastin e marrëdhënieve kulturore-shkencore, mund të supozohet se pala jugosllave ishte e interesuar për të zhvendosur bashkëpunimin kulturor-shkencor nga Kosova në republikat tjera jugosllave. Por, me ashpërsimin e akuzave reciproke, marrëveshjet për shkëmbime kulturore-shkencore ishin pezulluar, ndërsa profesorët nga Shqipëria ishin akuzuar se kishin përhapur nacionalizmin shqiptar në Kosovë.

Kah mesi i prillit situata në Kosovë filloi të normalizohej. U rihapën shkollat fillore, kurse ishin duke u bërë përgatitje edhe për rifillimin e mësimin në shkolla të mesme dhe në Universitet të Prishtinës. Por, forcat e sigurisë qëndronin në pika strategjike dhe vazhdonin të ishin në fuqi ndalimi i tubimeve publike.

Pas rivendosjes së rendit dhe të qetësisë filloi një fushatë e ashpër kundërshqiptare. Udhëheqja më e lartë jugosllave i cilësoi zhvillimet në Kosovë si të orientuara kundër rendit kushtetues në Jugosllavi. Zyrtari i lartë partiak, Lazar Mojsov, e cilësoi “Partinë Komuniste Marksiste-Leniniste të Shqiptarëve në Jugosllavi” si organizatore të demonstratave, dhe si një “Qendër e agjencive të huaja” që fshihej prapa parullave marksiste-leniniste. Njëjtë kishte deklaruar edhe Heljeviqi, zyrtar i lartë federal i sigurisë, por ai e shtonte edhe një organizatë tjetër shqiptare, atë të “Lëvizjes për Çlirimin e Kosovës”. Që të dy, pretendonin se këto organizata kishin lidhje me regjimin në Shqipëri. Bazuar në këto qëndrime filloi një fushatë e egër e diferencimit ideopolitik që preku udhëheqjen e Kosovës. Në strukturat partiake në Kosovë u vunë njerëz besnikë të idesë jugosllave.

Në kohën kur gjendja në Kosovë ishte qetësuar ambasadori Bolland pas analizimit të ngjarjeve dhe bisedave me palë të ndryshme arriti në konkluzionin se demonstratat kishin qenë të organizuara dhe të drejtuara nga shqiptarë të motivuar politikisht, kryesisht studentët. Parullat dhe banderolat kishin qartazi natyrë irredentiste dhe nacionaliste shqiptare. Ndonëse në këto demonstrata mund të ishin përfshirë elemente nga spektri i majtë dhe i djathtë shqiptar, Bollandi shkaku e këtyre ngjarjeve e adresonte tek nacionalizmi shqiptar.

Ndërsa fliste për nacionalizmin shqiptar në Kosovë, Bollandi rrënjët e një nacionalizmi të tillë

i shihte tek përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, pra vitet 1944-1945, kur ishte shtypur pa mëshirë rezistenca e shqiptarëve të Kosovës të cilët nuk kishin dashur të bashkoheshin me Jugosllavinë. Rezistenca shqiptare kishte vazhduar në njëfarë shkalle të kufizuar gjatë viteve pasuese. Gjatë viteve ‘70-të u burgosën disa anëtarë të “Lëvizjes Kombëtare Shqiptare”. Duke i bërë një analizë kërkesave politike të demonstratave, Bollandi erdhi në përfundim se kërkesat e nacionalistëve shqiptarë të Kosovës luhateshin midis bashkimit me Shqipërinë dhe pavarësisë nga Serbia si Republikë brenda Jugosllavisë, megjithëse kjo e fundit mund të ishte vetëm një fazë drejt së parës. Në fund ai theksonte se përmes ndryshimeve të statusit kushtetues përgjatë viteve, Kosova kishte lëvizur një hap më afër vetëvendosjes në Jugosllavi, por ishte e qartë se nacionalistët nuk ishin të kënaqur me tutelën e Serbisë, edhe pse ata kanë fituar barazinë pothuaj në çdo drejtim tjetër me republikat e Jugosllavisë.

Me fjalë tjera, Bolland tërthorazi e konsideronte nacionalizmin e shqiptarëve të Kosovës si një nacionalizëm autentik, duke reflektuar tone të mospërfshirjes së Shqipërisë në këto demonstrata, edhe pse një gjë e tillë ishte e vështirë të vërtetohej për shkak të retorikës që ndiqte shteti shqiptar lidhur me të drejtat e shqiptarëve në Kosovë, sidomos kur ambasadori shqiptar në Beograd kishte shprehur pakënaqësi me kufijtë aktualë të Jugosllavisë.

Britanikët nuk kishin gjetur as prova të përfshirjes së sovjetikëve. Së pari, politika sovjetike kundrejt Jugosllavisë nuk kishte ndryshuar pas vdekjes së Titos, marrëdhëniet vazhdonin të mbeteshin të qeta, ndërsa çdo ndërhyrje sovjetike mund të pasohej me zgjimin e armiqësisë jugosllave kundër Bashkimit Sovjetik. Akuzat për “kominformistët” nuk ishin vërtetuar asnjëherë, e po ashtu u vlerësua se Jugosllavia nuk kishte asnjë interes të ndërhynte në çështjen e Polonisë e t’i rrezikonte marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik. Në analizën që i bënë deklaratave të politikanëve jugosllavë, britanikët erdhën në përfundim se nuk kishte ndërhyrje sovjetike, kurse deklaratat e ambasadorit jugosllav se prapa demonstratave qëndronin sovjetikët, u vlerësua si përpjekje që përgjegjësia t’u hidhet agjencive të huaja.

Pasi nuk kishin gjetur prova të përfshirjes së sovjetikëve në demonstrata, britanikët nuk e përjashtonin mundësinë që shkaqet politike të demonstratave të kishin qenë derivat i ankesave ekonomike dhe sociale. Krizën e problemeve ajo e shihte brenda në Jugosllavi. Me gjithë përpjekjet për zhvillim Kosova megjithatë ishte rajoni më i pazhvilluar ekonomik në Jugosllavi, kurse një numër i madh studentësh të diplomuar

përballeshin me papunësi.

Por, krahas kërkesave shqiptare, në dokumentet britanike jepet edhe një vështrim mbi pretendimet e nacionalizmit serb, duke argumentuar arsyet e mospërbushjes së kërkesave shqiptare. Në këtë kontekst, duke u bazuar në çdo kriter logjik, sipas raportit që reflektonte perceptimet e diplomatit britanik, Kosova duhej të kishte status të barabartë me republikat e Sllovenisë, Malit të Zi e të Maqedonisë, meqenëse popullsia e saj është aq e madhe dhe etnikisht homogjene. Por, Partia Komuniste e Jugosllavisë nuk kishte pasur vullnet t’i kundërvihet serbëve ngaqë këta e kishin humbur Maqedoninë dhe Bosnjë-Hercegovinën nga Serbia e Madhe e para Luftës së Dytë Botërore. Po ashtu, Kosova trajtohej nga serbët si zemra e mbretërisë mesjetare serbe e shkatërruar nga turqit më 1389. Për më tepër, pas vitit 1948 Shqipëria ishte në raporte armiqësie me Jugosllavinë, dhe kjo e fundit nuk mund të kishte një republikë shqiptare në Kosovë e cila mund të tjetërsohej. Në këtë mënyrë, Partia u detyrua të ndiqte një politikë pa kompromis në këtë drejtim, sepse me Republikën e Kosovës do të donin të bashkoheshin komunitetet shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi, e më pas diçka të tillë do të kërkonin edhe pakicat tjera në Jugosllavi. Këto konstatime mbështeteshin me citimet e Stane Dollancit se “Krijimi i një Republike do të thoshte absolutisht padyshim një sulm për integritetin e Jugosllavisë”, dhe të sekretarit të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, Dragosavcit se “Çështja e Kosovës është e zgjidhur, ajo është pjesë integrale e Serbisë dhe Federatës Jugosllave”. Në sytë e britanikëve, çështja e Kosovës ishte një problem endemik të cilin nuk kishte arritur ta zgjidhte Tito me gjithë autoritetin dhe karizmin e tij, ndërsa udhëheqja jugosllave pas Titos veçse e kishte pranuar se nuk mund t’i jepnin një zgjidhje këtij problemi. Por, megjithatë, përmes përdorimit të forcës ata arritën t’i mbanin trazirat nën kontroll.

Në fund të raportit Bollandi paraqiti edhe pozicionimin e Britanisë së Madhe karshi çështjes së Kosovës. Britania, thoshte ai, nuk e ka ndërmend të përfshihej në mosmarrëveshjet lokale ballkanike e as t’i përmbahet kërkesave jugosllave për t’i kufizuar emigrantët shqiptarë. Kryeministra jonë, kishte deklaruar atë çfarë jugosllavët e perceptuan me kënaqësi - vlerat që Britania i jepte integritetit territorial dhe pavarësisë së Jugosllavisë. Me këtë qëndrim, Britania nuk i mbështeti kërkesat shqiptare për Republikë, sepse kjo do të çonte në shpërbërjen e Jugosllavisë. Prandaj, ndonëse preferonte të mos ngatërrohej në çështjet ballkanike, megjithatë qeveria britanike ndërmori edhe një veprim konkret në favor të

stabilitetit dhe të tërësisë territoriale të Jugosllavisë - ajo miratoi vendimin për të eksportuar në Jugosllavi një sasi të konsiderueshme të pajisjeve për kontrollimin e trazirave.

Përfundim

Në mars dhe prill të vitit 1981 në Kosovë shpërthyen studentore shqiptare me kërkesën kryesore për ngritjen e statusit juridik të Kosovës. Këto demonstrata u zhvilluan në një kohë kur bota ishte në kulmin e Luftës së Ftohtë midis Lindjes dhe Perëndimit dhe kur dy blloqet në fjalë po e vëzhgonin qëndrueshmërinë e Jugosllavisë pas vdekjes së liderit të saj suprem, Titos. Një vëmendje ndaj Jugosllavisë dhe ngjarjeve në Kosovë i kushtoi edhe Britania e Madhe, si njëra nga shtetet më të fuqishme të bllokut të demokracive perëndimore. Diplomatët britanikë të akredituar në Beograd ndoqën gjitha zhvillimet lidhur me Kosovën. Interesimi britanik, përveç rrjedhës së ngjarjeve, orientohej edhe në gjendjen e përgjithshme në Kosovë, origjinën dhe kërkesat e demonstratave, përfshirjen e shteteve tjera, pasojat etj. Duke analizuar dokumentacionin në dispozicion mund të arrihet përfundimi se britanikët i shihnin të logjikshme kërkesat për avancimin e statusit juridik të Kosovës ngaqë Kosova kishte një popullatë të madhe homogjene njëjtë sikurse republikat e Sllovenisë, Maqedonisë dhe e Malit të Zi. Por, ajo vinte theksin edhe në mundësinë e shpërbërjes së Jugosllavisë në rast se një kërkesë e tillë mund të aprovohej, duke pretenduar kundërshtimin e ashpër të nacionalizmit serb. Një pistë tjetër e interesimit britanik ishte përfshirja e shteteve tjera, në veçanti e Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë. Tek aleatët perëndimorë ekzistonte frika e vendosjes së ndikimit sovjetik në Jugosllavi. Duke mos gjetur prova të përfshirjes sovjetike, dhe duke mos mundur të vërtetohet përfshirja e Shqipërisë, diplomatët britanikë vunë në pah nacionalizmin e shqiptarëve të Kosovës, i cili që nga mbetja e Kosovës në Jugosllavinë socialiste kishte luftuar në forma dhe mënyra të ndryshme për të drejta kombëtare. Në këtë aspekt, britanikët origjinën e demonstratave e shihnin tek shqiptarët e Kosovës, kurse si shkas tjetër përveç të drejtave kombëtare, e shihnin edhe gjendjen e rëndë ekonomike në Kosovë. Si përfundim, Britania e Madhe mbeti e rezervuar ndaj zhvillimeve në Kosovë, duke u shmangur nga çdo përfshirje e mundshme në problemet ballkanike. Në të njëjtën kohë, ajo shprehu pozicionin e saj në aspekt të respektimit të sovranitetit dhe integritetit territorial të Jugosllavisë.

* Autori është drejtor i Institutit të Historisë - Prishtinë

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Drita mbete baras me Gjilanin, Ballkani shpallet kampion



Ballkani është shpallur kampion i Superligës katër xhiro pa përfunduar kampionati. Në fakt, barazimi 0-0 në mes të Gjilanit dhe Dritës i ka mjaftuar skuadrës nga Suhareka për ta arritur suksesin më të madh në histori të saj. Të mërkurën Dukagjini ka regjistruar një fitore të rëndësishme ndaj Ulpianës, kurse Prishtina me rezultat bindës e ka mposhtur Feronikelin. Sot (e enjte) zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera dhe takohen Drenica - Llapi dhe Ballkani - Malisheva

- Drita, ka reaguar nëpërmjet një postimi në "Facebook": "Historia u shkrua. Ne ia dolëm. Jemi kampionë".

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 4 MAJ - Derbi në mes të Dritës dhe Gjilanit ka përfunduar pa fitues (0-0). Ky rezultat e ka shpallur Ballkanin e Suharekës kampion të Kosovës për edicionin 2021/2022. Rastet nuk munguan në derbin e skuadrave nga Anamorava, por asnjëra prej skuadrave nuk arriti t'i konkretizojë në gol. Në këtë mënyrë skuadra e Ballkanit shpallet kampion, katër xhiro pa përfunduar kampionati. Kjo është hera e parë për klubin nga Suhareka

që e arrin një sukses të tillë, prandaj edhe është historik. Momentalisht, Ballkani ka 70 pikë, 11 më shumë se Gjilani dhe 13 më shumë se Drita, që kanë edhe nga tri ndeshje të mbetura. Fitore shumë të rëndësishme ka shënuar Dukagjini i Klinës në përballje me Ulpianën (2-1). Në pjesën e parë vendasit e humbën një penallti, pasi kapiteni Merkalu nuk u tregua i saktë. Skuadra mysafire kaloi e para në epërsi me golin e shënuar nga Shkala në minutën e 78. Dukagjini e barazoi rezultatit pesë minuta më

vonë me golin e Mentor Zhdrellës nga penalltia, kurse Jashanica realizoi në minutën e pestë shtesë për fitoren 2-1. Fitore me rezultat të thellë ka regjistruar Prishtina në përballje me Feronikelin (5-0). Sulley me dy gola dhe Zeka e John me nga një gol kontribuuan në pjesën e parë për rezultatit 4-0, ndërsa Sulley realizoi edhe një gol në pjesën e dytë për rezultatit final 5-0. Sot (e enjte) zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera. Në Skenderaj Drenica e pret skuadrën e Llapit, kurse kampionët e rinj të elitës e

presin Malishevën.

Ballkani: Historia u shkrua. Ne ia dolëm. Jemi kampionë

Drita barazoi me Gjilanin pa gola dhe ky rezultat i konvenoi skuadrës së Ballkanit për ta siguruar titullin e parë në histori. Janë edhe katër ndeshje për t'u zhvilluar, por klubi nga Suhareka tashmë e ka të siguruar titullin dhe ndeshjet e fundit do t'i zhvillojë vetëm për statistika. Ballkani, pas përfundimit të derbit Gjilani

SUPERLIGA - Java e 33

Prishtina - Feronikeli	5-0
Gjilani - Drita	0-0
Dukagjini - Ulpiana	2-1

Të enjten takohen:
15:00 Drenica - Llapi
15:00 Ballkani - Malisheva

Tabela

		Pikë
1. Ballkani	32	70
2. Gjilani	33	59
3. Drita	33	57
4. Llapi	32	54
5. Prishtina	33	45
6. Dukagjini	33	45
7. Malisheva	32	40
8. Drenica	32	40
9. Ulpiana	33	24
10. Feronikeli	33	12

Ish-komandanti i UÇK-së emërohet anëtar i KE të FFK-së



Prishtinë, 4 maj - Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës të mërkurën i është shtuar një anëtar i ri. Me propozim të presidentit Agim Ademi, ish-futbollisti Sylejman Selimi është emëruar anëtar i KE të FFK-së. Sylejman Selimi ishte një nga futbollistët më të shquar të kohës. Gjatë viteve '80, kur ishte në filllet e karrierës, Selimi mbrojti ngjyrat e klubeve KF Malushgat (Dukagjini) dhe KF Buduqnosti nga Skenderaj, ndërsa në vitet '90-'96, karrierën e tij prej futbollisti e zhvilloi në KF Drenica. Ish-mesfushori drenicas ishte

edhe pjesë e Kombëtares së Kosovës të asaj kohe. "Dëshira për të kontribuar në zhvillimin e futbollit kosovar vazhdoi edhe pas luftës së fundit në vend, me ç'rast angazhimin e tij e vazhdoi në struktura udhëheqëse, në vitin 1999-2000 ishte president i KF Drenica, kur edhe klubi ishte inkuadruar për herë të parë në Superligë, më pas në periudhën 2000-2001 Selimi ishte drejtor dhe më pas edhe kryetar i Klubit të Futbollit Prishtina. Gjeneral Selimi asnjëherë nuk u shkëput nga futbollit. Ai vazhdon të jetë pjesë e Ligës dhe Kombëtares së Veteranëve", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Përfaqësueset e FIBA-s vizitojnë Kosovën para Evropianit



PRIZREN, 4 MAJ - Dy përfaqësueset e FIBA-s, Zane Jurjane dhe Vasiliki Kalaitzaki, kanë vizituar Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe Prizrenin para Evropianit të Divizionit C. Jurjane dhe Kalaitzaki janë pritur nga

kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu, më pas kanë vizituar Prizrenin, aty ku pritet të mbahet Evropiani i Divizionit C për meshkuj U16. Ato kanë parë nga afër palestrën 'Sezai Surroi' në Prizren,

gjithashtu janë interesuar edhe për akomodimin, transmetimin dhe gjithë organizimin e kësaj gare.

Në Evropianin e Divizionit C garojnë tetë shtete që janë ndarë në dy grupe. Kosova do të jetë në

grup me Shqipërinë, San Marinon dhe Maltën, kurse në grupin tjetër janë Andorra, Gjibraltari, Moldavia dhe Armenia. Kampionati zhvillohet 12 deri më 17 korrik. FBK-ja ka përvijë në organizimin

e ngjarjeve ndërkombëtare dhe për këtë ka marrë edhe lëvdata nga FIBA. Më herët në Kosovë është organizuar Evropiani i Divizionit C për meshkujt U18, Divizioni B për femra U20 dhe Challenger i meshkujve 16.

Audi dhe Porsche, gati për debutimin në gara Formula 1

BERLIN, 4 MAJ - Duke nisur nga viti 2026, në Formula 1 do të hyjnë edhe dy marka të rëndësishme të automobilizimit, Audi dhe Porsche. Atë vit do të hyjnë në fuqi edhe rregullat e reja teknike që u japin mundësi këtyre dy markave të garojnë në sportin më të bukur të shpejtësisë. Lajmin e konfirmoi Herbert Diess, administratori i deleguar i

Wolkswagenit. Për Audi ky është një debutim absolut në Formula 1, ndërsa për Porsche ky është një rikthim teksa është larguar nga Formula 1 në vitin 1991. "Hyryja jonë në sportin e Formulës 1 është e lidhur me popullaritetin që ka ky sport në botë. Formula 1 po zhvillohet në mënyrë pozitive nën drejtimin e Liberty Media. Planet tona janë shumë të avancuar për sa i

përket Porsches dhe disi më pak me Audi", ka thënë Diess. "Kishim nevojë për një ndryshim të rregullores për të hyrë në këtë sport. Duhet 3-4 vjet për të zhvilluar një motor, ndërkohë që rregullat aktuale janë miratuar që para 9 vjetësh. Mendojmë se nga viti 2026 e në vazhdim Formula 1 do të jetë sporti më spektakolar i garave", ka shtuar Diess.





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR

AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE

AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

QENDRA E KOMPETENCËS "KUJTIM KRASNIQI" MALISHEVË
CENTRI QI KOMPETENCI "KUJTIM KRASNIQI" MALISHI VËNumër: 249 /4
Datë: 04.05.2022

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës, dhe sipas nenit 12 Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë shpall:

Konkurs

Për regjistrimin e vijueseve për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve, për klasë e X- të në profilin:

1. Hoteleri dhe turizëm

Në këtë afat do të pranohen 15 kandidatë për vijimin e Arsimit dhe Aftësimin për të Rritur.

Afati do të jetë i hapur nga data 05.05.2022 e deri më 19.05.2022.

Kushtet

-Regjistrimi i vijuesve në programin "Arsimin për të rritur" bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt, siç është paraparë në nenin 10.2 pikat (a, b) dhe nenit 17.3 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë.

-Në programin "Arsimi për të rritur" në shkollat e mesme të larta vijuesve ju mundësohet që një vit të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18 javë mësimi [UA nr. 12/2011 MASHT].
Për regjistrim kanë të drejtë të gjithë të interesuarit të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

1. Dëftesat e klasave të kryer paraprake
2. Certifikatën e lindjes
3. Fletëpagesën prej 150€ (e cila merret në shkollë), për regjistrimin e klasës së 10.

Dokumentet për regjistrim dorëzohen në shkollë.

Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë, participimi bëhet në bazë të Udhëzimit Administrativ, MASHT Nr. 11/2011

Pagesa e vijuesve për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur në shkollat e mesme të larta profesionale do të jetë :

1. Për regjistrim të vitit për një klasë, dhe punë praktike _____ 150.00€
2. Për ç'do provimin diferencial nga _____ 10.00€
3. Për provimet përfundimtare të klasës (certifikata dhe diploma) _____ 50.00€

Vijuesit të cilët ndërrojnë profilin do të i nënshtrohen provimeve diferenciale bazuar në UA 12/2011.

Kandidatet të cilët e ndërrojnë drejtimin janë të obliguar që paraprakisht ti nënshtrohen provimeve plotësuese dhe diferenciale.

Dhënia e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë nga vijimi i klasës për të cilën kandidati është paraqitur për regjistrim.

Diplomat që merren në programin "Arsimi dhe aftësimi për të rritur" janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Leutrim Gutaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Heronjtë e Lumës" Vermicë.
- ▶ Çlirim Kastrati shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Albrim Gashi shpall te pavlefshme VI - IX SHFMU "17 Shkurti" Hatmaxhe.
- ▶ Albrim Islamaj shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Besarta Krasniqi shpall te pavlefshëm diplomën e Fakultetit të Edukimit-Programi Fillor e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, "Hasan Prishtina", Prishtinë.
- ▶ Suhejb Ibra shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Eqrem Çabej" nga klasa 6-9.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



Republika e Kosovës Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosovo/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 307/2022 të datës 15 shkurt 2022, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS

I. Administrator i lartë i sigurisë së TI-së

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, një (1) pozitë

Referenca: KPK/SKPK/POZ-007
Emri pozitës: Administrator i lartë i sigurisë së TI-së
Pozita: Pozitë e karrierës
Niveli: Profesional
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë
Koeficienti: Nëntë (9)
Akt emërim: Pa afat
Puna provuese: 12 muaj
Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit Zhvillon, përditëson dhe zbaton politikën dhe procedurat për sigurinë e sistemeve të TI-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Zhvillon, përditëson dhe zbaton politikën dhe procedurat për sigurinë e sistemeve të TI-së; Menaxhon dhe administron Firewall-at, si dhe pajisjeve tjera të rrjetit sipas nevojës; Instalton, administron dhe mirëmban softuerët dhe harduerët e sigurisë, duke përfshirë, por jo kufizuar, "firewall-ët", IPS (Intrusion Prevention System), SIEM (Security Information and Event Management), antiviruset dhe sisteme tjera sipas nevojës; Kujdeset për konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e infrastrukturës së TI-së dhe informatave, duke zbatuar praktika të mira; Mbron sistemet kundër qasjes së paautorizuar, modifikimit dhe/ose shkatërrimit. Kujdeset për sigurinë dhe mbrojtjen e infrastrukturës komunikuese elektronike dhe të dhënave dhe sipas nevojës, ndihmon institucionet relevante në luftimin e kimit kibernetik (cyber crime); Kryen monitorime të trafikut të rrjetit, analizon dhe vendosë mekanizmat e sigurisë në sisteme; Përditëson dhe zbaton protokollet për vazhdimësinë e punës dhe të rimëkëmbjes pas fatkeqësive; Propozon projekte të reja për zhvillim, bazuar në nevojat dhe kërkesat e institucionit; Kryen auditime të sigurisë dhe bën rekomandime të politikave si dhe përgatit raporte në baza periodike;

Kryen detyra të tjera të deleguara nga Udhëheqësi i Divizionit për Infrastrukturë (rrjet dhe server)

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Njohje të punës në Firewall, DNS, DHCP, IDS, IPS, VPN, catalyst, ASA Firewall dhe perimetër router
Njohuri mbi pajisjet kompjuterike të shfrytëzuesve, pajisjet periferike dhe pajisjet ndihmese
Trajtime dhe certifikime në CCNA, CEH apo në ndonjë trajnim tjetër relevant
Njohja e gjuhës angleze;
Shkathsi për punë ekipore;
Shkathsi për hartim të akteve dhe shkresave dhe në komunikim;
Shkathsi për të caktuar synimet më të rëndësishme dhe dhënia e prioritetëve atyre;
Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me të;
Aftësia për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion;
Reagimi i duhur në zgjidhjen e problemeve.
Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:
Diplomë Universitare ne shkencat kompjuterike, informatikë dhe të ngjashme.
Përvoja e Punës:
Tri (3) vite përvojë pune në fushën e TI-së.

II. Administrator i lartë i TI-së për Baza të të Dhënave

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, një (1) pozitë

Referenca: KPK/SKPK/POZ-008
Emri pozitës: Administrator i lartë i TI-së për Baza të të Dhënave
Pozita: Pozitë e karrierës
Niveli: Profesional
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë
Koeficienti: Nëntë (9)
Akt emërim: Pa afat
Puna provuese: 12 muaj
Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Sisteme Elektronike (softuer), Administratori i lartë TI-së për baza të të dhënave është përgjegjës për administrimin e gjitha aplikacioneve në sistemin prokurorial, zhvillim të procedurave për masat e sigurisë së aplikacioneve dhe funksionim të tyre.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Zhvillon dhe implementon aplikacionet/module te reja, sistemet softuerike, dhe/ose përmirësimin e aplikacionit ekzistues në kuadër të SKPK-se;
Instalton, konfiguron dhe administron në mënyrë efektive ueb serverët;
Kryen veprime të përditshme të zhvillimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të sistemeve, duke përfshirë edhe funksionet e administrimit të bazës së shënimeve, konfigurimin dhe përshtatjen/akordimin e performances së aplikacioneve dhe bazave të shënimeve të aplikueshme në sistemin prokurorial;
Siguron mirëmbajtjen dhe mbështetjen teknike për sistemet duke përfshirë përcaktimin dhe korrigjimin e problemeve teknike;
Kryen instalimin e sistemeve dhe bazave të shënimeve duke përfshirë instalimin dhe konfigurimin e komponentëve të anës së klientit.

Negocionin me mes të përdoruesve të sistemeve dhe bazave të shënimeve dhe ofruarve të jashtëm të shërbimeve në mënyrë që të arrihet një zgjidhje e shpejte e problemeve. Ofron asistencë teknike dhe trajnime për përdoruesit fundor.

Asistencë gjatë procesit të përzgjedhjes dhe të analizës të punës së sistemeve apo bazave të shënimeve të reja, ridisnjimin, plotësimin me të dhëna dhe uljen/reduktimin e duplikimit të të dhënave, çështjet e krijimit dhe të integritetit. Bëjnë administrimin e ueb aplikacioneve, merret me ngjarjet (events), mbështetjen, kopjet rezerve (back up) dhe rikthimin (recovery) e tyre në funksion;

Kujdeset për të rregulluar punën e regjimit të sigurisë së aplikacioneve, zbulimit eventual të ndërhyrjeve pa leje dhe sanimit që shkaktohen nga këto ndërhyrje në sistemet e TI-së. Përgatit dokumentacionin e sistemit, udhëzimet punuese dhe procedurat standarde të punës në bashkëpunim të ngushtë me palët tjera përkatëse të kësaj;

Të sigurojë që procedurat e testimit janë të përcaktuara/definuara, të dokumentuara dhe të zbatueshme.

Analizon dhe vlerëson proceset e punës së rregullt që duhet të kryhet.

Kryen çdo detyrë tjetër që korrespondon ose mund të ndihmojë në kryerjen e funksioneve të administratorit të bazës së të dhënave për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e funksioneve të infrastrukturës së sistemeve. Kryen çdo detyrë tjetër që korrespondon ose mund të ndihmojë në kryerjen e funksioneve të administratorit të bazës së të dhënave për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e funksioneve të infrastrukturës së sistemeve.

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Certifikata për zhvillimin e aplikacioneve në platformën e Microsoft apo te ngjashme - përparësi;

në programin si në: Java, ASP.Net, C#, VB.Net, XML, Web Services, HTML dhe platforma të tjera të njohura në web;

Kuptoj dhe mbështet përkthimin e kërkesave funksionale të sistemeve në prokurori;

Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;

Shkathësi hulumtues, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare në Inxhinieri Kompjuterike ose Shkenca Kompjuterike.

Përvoja e Punës:

Tri (3) vite përvojë pune në fushën e TI-së.

III. Zyrtar për Arkiv 2

Prokuroria Themelore Gjakovë, një (1) pozitë

Prokuroria Themelore Gjilan, një (1) pozitë

Referenca: KPK/ZKSHP/PA/PSRK/PTH/POZ-009
Emri pozitës: Zyrtar për Arkiv 2
Pozita: Pozitë e karrierës
Niveli: Profesional
Raporton tek: Administratori i Prokurorisë
Numri i pozitave: Dy (2) pozita
Koeficienti: Shtatë (7)
Akti i emërimit: Pa afat
Puna Provuese: 12 muaj
Vendi: Gjakovë, Gjilan

Qëllimi i vendit të punës:

Arkivimi, sistemimi dhe mbajtja azhure e lëndëve të institucionit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Pranon dokumentet dhe lëndët për arkivim dhe kujdeset për arkivimin e tyre në arkivin e institucionit në përputhje me procedurat ligjore.

Kujdeset për sistemimin dhe mbajtjen azhure të lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit.

Mirëmban arkivin e veçantë për rastet e detajuara specifike dhe ruan paprekshmërinë e informatave.

Përkujdeset për seleksionimin e rregullt të lëndës arkivore.

Mbanë kontakte të vazhdueshme me institucionet e arkivit të Kosovës, me qëllim të dorëzimit të lëndëve arkivore arkivit kompetent pas kalimit të afatit.

Ndërmerr veprime tjera të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të ligjit mbi lëndën arkivore të Kosovës.

Koordinon punën me nëpunësin që merret me postën dhe shpërndarjen e postes, shkresave jashtë dhe brenda institucionit.

Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;

Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata ,dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;

Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;

Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel);

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare.

Përvoja e Punës:

Dy (2) vite përvojë pune.

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data **05.05.2022 deri me datë 19.05.2022** si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në ueb faqen: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vullën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
 - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
 - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
 - "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
 - Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:
 - Dëshminë e kualifikimit shkollor;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi dhe kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);
 - Dy rekomandime (nëse keni);
 - Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla); Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
 - Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetim.
- Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati/ Sekretarijat/ Secretariat



Na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 307/2022 od 15 februar 2022. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova objavljuje ovaj:

KONKURS

I. Viši Administrator IT-a za Bezbednost

Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, jedna (1) pozicija

Referenca: KPK/SKPK/POZ-007
Naziv pozicije: Viši Administrator IT-a za bezbednost
Pozicija: Pozicija karijere
Nivo: Profesionalni
Izveštava: Šefu Odeljenja
Broj pozicija: Jedna (1) pozicija
Koeficijent: Devet (9)
Akt o imenovanju: Na neodređeno
Probni rad: 12 meseci
Mesto: Priština

Svrha radnog mesta:

Pod nadzorom šefa odeljenja razvija, ažurira i sprovodi politike i procedure za bezbednost IT sistema.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Razvija, ažurira i sprovodi politike i procedure za bezbednost IT sistema;
Upravlja i administrira Firewall, kao i druge mrežne uređaje po potrebi;
Instalira, administrira i održava sigurnosni softver i hardver, uključujući ali ne ograničavajući se na, "firewall", IPS (Intrusion Prevention System), SIEM (Security Information and Event Management), antivirusne i druge sisteme po potrebi;
Vodi računa o poverljivosti, integritetu i dostupnosti IT i informacione infrastrukture, primenjujući dobre prakse;
Štiti sisteme od neovlašćenog pristupa, modifikacije i/ili uništenja.
Brine o bezbednosti i zaštiti elektronske komunikacione infrastrukture i podataka i po potrebi pomaže relevantnim institucijama u borbi protiv sajber kriminala (cyber crime);
Vrši praćenje mrežnog saobraćaja, analizira i primenjuje bezbednosne mehanizme u sistemima;
Ažurira i implementira protokole za kontinuitet rada i oporavak od nepredviđenih događaja;
Predlaže nove razvojne projekte, na osnovu potreba i zahteva institucije;
Vrši bezbednosne revizije i daje preporuke za politike i priprema izveštaje na periodičnoj osnovi;
Obavlja i druge poslove koje delegira šef Odeljenja za infrastrukturu (mreža i server)

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Poznavanje rada u Firewall, DNS, DHCP, IDS, IPS, VPN, catalyst, ASA Firewall i router perimetar
Poznavanje računarske opreme korisnika, periferne opreme kao i pomoćne opreme
Obuka i sertifikati u CCNA, CEH ili iz neke druge relevantne obuke
Poznavanje engleskog jezika;
Sposobnost rada u timu;
Veštine za izradu akata i dokumenata i u komunikaciji;
Veštine da se postave najvažniji ciljevi i davanje prioriteta istima;
Sposobnost preduzimanja konkretnih inicijativa na poslu i u vezi sa istim;
Sposobnost održavanja kvaliteta rada čak i u uslovima rada pod pritiskom;
Pravilna reakcija u rešavanju problema;
Stručna obuka i kvalifikacija:
Univerzitetska Diploma kompjuterske nauke, informatike i sl.
Radno iskustvo:
Tri (3) godine radnog iskustva u oblasti IT-a.

II. Viši Administrator IT -a za Baze Podataka

Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, jedna (1) pozicija

Referenca: KPK/SKPK/POZ - 008
Naziv pozicije: Viši Administrator IT -a za Baze Podataka
Pozicija: Pozicija od karijere
Funkcionalna kategorija: Profesional
Raportira kod: Rukovodilac Divizije
Broj Pozicija: Jedna (1) pozicija
Koeficijent: Devet (9)
Akt o imenovanju: Na neodređeno
Probni Rad: Dvanaest (12) meseci
Mesto: Priština

Cilj radnog mesta:

Pod nadzorom šefa Oseka za Elektronske Sisteme (softver), Viši Administrator IT-a za Baze Podataka odgovoran je za upravljanje svim aplikacijama u sistemu tužilaca, razvijanje procedura za mere sigurnosti aplikacija i njihovo funkcionisanje.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Razvija i implementira nove aplikacije/module, softverske sisteme i/ili ispravljanje postojeće aplikacije u okviru STSK-a;
Instalira, konfigurira i upravlja veb servere na efektivan način;
Obavlja svakodnevne operacije razvoja sistema, održavanja i upravljanja sistema, uključujući funkcije administracije baze podataka, konfiguraciju i prilagođavanje/akordiranje performanse aplikacija i baze podataka primenljive na tužilačkom sistemu;
Obezbeđuje održavanje i tehničku podršku za sisteme uključujući određivanje i ispravljanje tehničkih problema;
Obavlja instalaciju sistema i baze podataka uključujući instalaciju i konfiguraciju komponenti za klijente;
Pregovara između korisnika sistema i baze podataka i spoljnih provajdera za usluge kako bi se došlo do brzog rešavanja problema. Pruža tehničku pomoć i obuku za krajnje korisnike.

Pomaže tokom procesa izbora i analize rada novih sistema ili baze novih podataka, redizajniranja, dopunjavanja podataka i smanjenja / reduktovanja dupliranja podataka, pitanja stvaranja i integracije.

Upravlja veb aplikacijama, bavi se događajima, podrškom, rezervnim kopijama (back up) i njihovo ponovno vraćanje u funkciji (recovery);

Pobrine se da uređuje rad režima aplikacijskih sigurnosti, eventualnog otkrivanja neovlašćenih intervencija i saniranja koja se uzrokuju ovim intervencijama u sistemima IT-a. Priprema dokumentaciju sistema, radna uputstva i standardne radne procedure u uskoj saradnji sa ostalim relevantnim strankama koje su uključene;

Obezbediti da procedure testiranja su određene/definisane, dokumentovane i sprovodne.

Analizira i ocenjuje procese redovnog rada koji se treba obavljati.

Obavlja svaki zadatak koji odgovara ili može pomoći u obavljanju funkcija administratora baze podataka kako bi povećao efikasnost i efektivnost funkcija sistemskih infrastrukture.

Znanja, veštine i iskustva za radno mesto:

Sertifikat za razvoj aplikacija na Microsoft platformi ili slično;
Iskustvo u programiranju: Java, ASP.Net, C #, VB.Net, KSMML, Veb usluge, HTML i druge poznate platforme na vebu;
Razumjeti i podržati prevod funkcionalnih zahteva sistema u tužilaštvo;
Veliko znanje u specifičnu stručnu oblast stečeno kroz univerzitetsko obrazovanje i odgovarajuću obuku;
Istraživačke, analitičke, evaluacijske veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
Stručna sprema i kvalifikacije:
Univerzitetska Diploma Kompjuterske Inžinjerije ili Kompjuterskih Nauka.
Radno iskustvo:
Tri (3) godine radnog iskustva u oblasti IT-a.

III. Službenik za Arhive 2

Osnovno Tužilaštvo Đakovica, jedna (1) pozicija
Osnovno Tužilaštvo Gnjilane, jedna (1) pozicija

Referenca: KPK/ZKSH/PA/PSRK/PTH/POZ-009
Naziv pozicije: Službenik za Arhivu 2
Pozicija: Pozicija od karijere
Nivo: Profesional
Izveštava: Administratoru Tužilaštva
Broj pozicija: Dve (2) pozicija
Koeficijent: Sedam (7)
Akt imenovanja: Na neodređeno
Probni rad: 12 meseci
Mesto: Đakovica, Gnjilane

Cilj radnog mesta:

Arhiviranje, sistemiranje i ažurno održavanje predmeta institucije.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Prima dokumente i predmete za arhiviranje i pobrine se za njihovo arhiviranje u arhivi institucije u skladu sa zakonskim procedurama;
Pobrine se za sistemiranje i ažuriranje arhivnih predmeta, kao i predlaže potrebne uputnike za funkcionisanje arhive;
Održava posebnu arhivu za specifične detaljne slučajeve i čuva netaknutost informacija;
Pobrine se za redovnu selektiranje arhivnog predmeta;

Održava redovne kontakte sa institucijama arhive Kosova, u cilju dostavljanja arhivnih predmeta nadležnoj arhivi nakon isteka roka;

Preduzima ostale potrebne radnje za bolje funkcionisanje zakona o arhivnim predmetima Kosova;

Koordinira rad sa službenikom koji se bavi poštom i raspodele pošte, spisima van i unutar institucije.

Obavlja i ostale obaveze u skladu sa zakonom i pravilnicima koje se povremeno mogu zahtevati na razuman način od strane nadzornika.

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Sposobnosti za sprovođenje procedura i administrativnih uputstva za obavljanje radnih obaveza;
Komunikativne veštine uključujući sposobnost za interpretiranje informacija, pružanje uputstva i da prosledi informacije kod drugih;
Koodinativne sposobnosti i nadziranje rada osoblja u administrativnom i tehničkom nivou;
Kompjuterske veštine u aplikacije programa (Word, Excel).

Stručna sprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma.

Radno iskustvo:

Dve (2) godina radnog iskustva.

- *Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 05.05.2022 do 19.05.2022 kao datum isteka konkursa.*
- *Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org*
- *Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.*
- *Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.*
- *Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.*
- *U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.*
- *Uslovi učesča na konkursu:*
 - *Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.*
 - *Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.*
 - *„Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravredno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova“.*
- *Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:*
 - *Svedočanstvo školske spreme;*
 - *Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prihvataju kao dokaz radnog iskustva).*
 - *Dve preporuke (ako imate);*
 - *Kopije dva poslednja naizmjenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);*
 - *Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;*
 - *Uverenje od Suda da niste pod istragom.*
- *U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavješteni na osnovu važećeg zakonodavstva.*



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
(Listed in alphabetical order)
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

